



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 12 / Dhjetor 2025



Hyrja e tre muajve të mirë
REXHEB-SHABAN-RAMAZAN



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsh.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 12 (510)

Dhjetor, 2025


ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al

Përmbajtja



editorial

- 04** Hyrja e tre muajve të bekuar Rexhep, Shaban, Ramazan dhe nata e mirë Regaib / Editorial

në fokus

- 06** Rëndësia e përkthimit të librit “El Ihtijar” në gjuhën shqipe
H. Bujar Spahiu
- 08** Rreth redaktimit dhe recensimit të veprës “El Ihtijar”
Dorian Demetja

lajme / aktivitete

- 10** 01-Ihtijari dhe roli i tij në mendimin juridik islam
02-Zhvillohet seanca e parë shkencore
03-Zhvillohet seanca e dytë shkencore

refleksione

- 14** Ibn Sina: Gjuha e fesë dhe interpretimi “filozofik” i Kur’anit / Phd.Cand. Ledian Cikalleshi

çështje fetare

- 18** Besimtari mes durimit dhe falenderimit
Aorel Senja

familja

- 20** Gruaja myslimane dhe sfidat e botës moderne
Arjola Zaci

horizonti i besimit

- 22** Ky ishte Muhamedi (s.a.s.) i thjeshti, modesti
Redaksia
- 28** Ndikimi i islamit në mjekësinë botërore (2)
Dr. Ibrahim b. Sied
- 30** Rreth nesh, jo mbi ne
Ana Haxhiu
- 32** Ruajtja e trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe Uzbekistan / Msci. Ermal Bega

bota shpirtërore

- 34** Zhvillimi njerëzor në Kuranin famëlartë dhe Hadith
M. Albar Rahim

hapësirë femërore

- 36** Një vepër e vogël që shpëtoi një jetë
Hapësirë Femërore

këndi i poezisë

- 38** Fjalët e një kalorësi
Fatmir Muja

04



08



20



30



34



Hyrja e tre muajve të bekuar Rexhep, Shaban, Ramazan dhe nata e mirë Regaib



Koha dhe vendi, të gjithë vlerën dhe shenjtërinë e tyre e marrin sepse ashtu dëshiron Allahu. Kjo dëshirë hyjnore përfshin mijëra urtësi për krijesat. Veçanërisht, ato ngjarje që ndodhin brenda asaj kohe dhe vendi, i fitojnë këtyre një rëndësi të veçantë. Shenjtëria e disa aspekteve të kohës në Islam është një mënyrë që begatia dhe mirësia e pafund e Zotit të mbërrijë tek muslimanët.

Sipas kalendarit hënor, që ka si pikënisje hixhretin e profetit Muhamed (s.a.s.) (hixhri), muajt Rexhep, Shaban dhe Ramazan janë muaj shumë të dobishëm dhe të bekuar. Në shoqërinë Islame këta muaj quhen "Shuhur-u Thelathe" (Tre Muajt). Të gjitha netët e mira veç Natës së Mevludit, ndodhen brenda këtyre tre muajve. Muaji Rexhep cilësohet si muaji i mbjelljes, muaji Shaban si muaji i ujitjes dhe muaji i Ramazanit si muaji i korrjes apo mbledhjes së prodhimeve. Njeriu korr ç'ka mbjell,

merr barazvlerësen e asaj që ka bërë.

Tre muajt kanë një shije të vetën, e cila i veçon ata nga muajt e tjerë. Secili nga muajt ndjehet me ndjenjat tona të dukshme, ndërsa këta të tre, ndjehen me zemër dhe ndjenja mjaft të thella. Brenda kësaj kohe njerëzit që i kthehen botës së zemrës, preken shpirtërisht nga rrezet që burojnë nga besimi i tyre dhe u duket se në këtë gjendje ata do të jetojnë përgjithmonë në hare. Ditët, netët, madje orët dhe minutat gjatë kësaj kohe për ta, ecin në një formë të magjishme. E ashtu duke rrjedhur, pa dyshim që secilit i pëshpërijnë diçka në shpirt.

Këtë vit, muaji Rexhep nis më datë 21.12.2025, ditën e dielë të Dhjetorit.

Muaji Rexhep është muaji i faljes, amnistisë nga Allahu; muaji Shaban është muaji i shefaatit, ndërmjetësimit për falje; muaji Ramazan është muaji i shtimit të mirësive. Për këtë qëllim profeti ynë, në

fillim të muajit Rexhep, lutej kështu:

"Allahu im! Na i bëj të bekuara Rexhepin dhe Shabanin dhe na bashko me muajin e Ramazanit". Ndërsa në disa thënie të tjera të tij thotë: "Ai që agjëron ditën e parë, të mesit dhe të fundit të muajit Rexhep, shpërblehet sikur ka mbajtur me agjërim të gjithë muajin". "Rexhepi është një muaj i madh. Të mirat në këtë muaj Allahu i shumfishon" (Taberani). Pas muajit të Rexhepit vjen muaji i Shabanit. Hz. Aishe (r.a.) thotë: "Nuk e kam parë të dërguarin e Allahut të mbajë më shumë agjërim se sa në muajin e Shabanit". "Muaji Shaban i pastron gjynahet". Transmetohet nga Enes b. Malik se Profeti (a.s.) pyetet: O i dërguari i Allahut! Në cilin muaj është agjërimi më i mirë përveç Ramazanit? Pejgamberi përgjigjet: "Për nder dhe respekt të Ramazanit është agjërimi i mbajtur në muajin Shaban". I dërguari i Allahut në një hadith thotë: "Muaji Rexhep është i Allahut të lartë, muaji Shaban është i imi, kurse muaji Ramazan është i ymetit tim".

Dijetari i madh dhe i shquar Bediuzaman për këta muaj thotë: Shpërblimi i çdo të mire, nëse në kohë të tjera është dhjetë, në muajin Rexhep është njëqind, në muajin Shaban më shumë se treqind, në Ramazan ngjitet në njëmijë, në netët e Xhumave shkon me mijëra dhe në natën e Kadrit ngjitet në tridhjetëmijë.

Gjatë këtyre muajve muslimanët pendohen për mëkatet, zemërimet dhe mërimet u jepen fund, ndjenjat vëllazërore zhvillohen më tej, kështu, muslimanët bëjnë përpjekje për të hyrë me mendime të mira dhe kënaqësi në muajin e bekuar të Ramazanit.

Profeti ynë (a.s.) dhe sahabët punonin shumë për të kapur mirësitë e këtyre tre muajve. E shtonin shumë më tepër adhurimin me nafile (namaze suplementare), shtonin shumë dhikrin (përkujtimin), tesbihun (lartësimin), hamdin dhe shukrin (falenderimin) ndaj Allahut (xh.sh.), kërkonin falje, ndihmonin të varfërit, gëzonin jetimet, të vetmuarit dhe të moshuarit. Gjatë muajve Rexhep dhe Shaban u kushtonin vëmendje agjërit të ditëve të hëna dhe të enjte. Theksojmë se agjërimi i mbajtur në muajt Rexhep dhe Shaban është sunet.

Nata e mirë Regaib

Regaib në gjuhën arabe është shumësi i fjalës "ragibe", që do të thotë se kjo është nata e dhuntive, dhuratave, shpërblimeve dhe nxitëse për vepra të mira. Këtë vit, më datë 25.12.2025, kalon nata e mirë e parë Regaib.

Nata e mirë Regaib, sipas kalendarit hënor, bie natën e xhumasë së parë (nata që lidh ditën e enjte me të premte) të muajit Rexhep, i cili është edhe muaji i parë i Tre Muajve të mirë. Çdo natë e xhuma është e bekuar. Kur këto dy netë puqen

bashkë nata bëhet akoma më e bekuar dhe më e dobishme. Me vlerat e mëdha që përmban kjo natë, është njëkohësisht sihariqi dhe lajmëtari i parë i muajit të Ramazanit. Në aspektin psikologjik kjo është shumë e rëndësishme, sepse besimtari hyn në një parapërgatitje shpirtërore dhe e drejton veten e tij kah adhurimeve, përgjegjësi individuale dhe familjare duke urdhëruar të mirën e duke ndaluar të keqen.

Në popull është konceptuar gabim fakti që në këtë natë ka mbetur shtatëzanë nëna e profetit tonë, Emineja. Vetë data e lindjes së profetit tonë nuk e vërteton këtë hipotezë. Mundet që në këtë natë Emineja ta ketë kuptuar që ishte shtatëzanë. Një komentim i tillë i këtij koncepti do të ishte më i përshtatshëm.

Sipas mendimeve të dijetarëve Islam, në këtë natë Allahu i madhëruar e ka begatuar profetin Muhamed (s.a.s.) me dhunti dhe dhurata shpirtërore shumë të çmuara. Edhe profeti ynë i dashur e ka lavdëruar dhe falenderuar Allahun (xh.sh.) me lutje, teube (pendesë) dhe namaz.

Allahu natën e Regaibit i jep muslimanëve mirësi dhe begati të panumërta. Kjo është nata kur pranohen lutjet, pendesat dhe kur shpërblimet e adhurimeve janë të mëdha e të shumta. Profeti ynë i nderuar, në një hadith të transmetuar nga Enesi (r.a.) thotë: "Kujdes, përpiku të rrish zgjuar natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep, të mos e kalosh atë në shkujdesje, sepse engjëjt asaj nate ia kanë vënë emrin Regaib!" Ndërsa në disa thënie të tjera për rëndësinë e kësaj nate Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë: "Ai që e vlerëson natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep (Nata e Regaibit), Allahu i madhëruar nuk e dënon në varr" (Saadet-i Ebedije). "Lutja që bëhet në këto pesë netë nuk kthehet mbrapsht: Në natën e Regaibit, natën e 15 të Shabanit, të Xhumanë, natën e Bajramit të Ramazanit dhe të Kurbanit" (Ibn-i Asakir).

Si përfundim themi që kjo natë duhet vlerësuar nga besimtarët me namaz, me lexim Kur'ani, me teube istigfar, i dërgohen salavate Profetit, dita e enjte agjërohet dhe në darkë kryhen adhurime të llojeve të ndryshme, gjithashtu, kjo natë kalohet edhe me punë të tjera të dobishme dhe sevappurëse në fenë tonë. Nuk duhet të harrojmë që lutjet tona të fillojnë dhe të mbarojnë me salavate për profetin, duke ditur që lutja midis dy lutjeve të pranuar tek Zoti, pranohet.

* Shkëputur nga libri "Ditët dhe netët e mira në Islam", Botim i KMSH-së, 2007.

Rëndësia e përkthimit të librit “El Ihtijar” në gjuhën shqipe

Përkthimi në gjuhën shqipe i veprës “El Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr”, është një kontribut i çmuar juridiko-fetar që zë një rol të rëndësishëm në trashëgiminë e fikhut hanefi dhe në historinë e zhvillimit të dijes së normave të Islamit ndër shekuj.

Së pari: Rëndësia e librit El Ihtijar

Vepra El Ihtijar e imam Abdullah ibn Mahmud el-Mavsuliut zë një ndër pozicionet më qendrore në korpusin juridik të medhhebit hanefi dhe konsiderohet gjerësisht si një prej burimeve themelore dhe më të besueshme të kësaj shkolle. Ajo përfaqëson një nga komentimet më të thelluara dhe metodologjikisht më të strukturuar mbi veprën El-Munteka, që përmban përzgjedhjet juridike të imam Kuduriut. Karakteristika që e ka shndërruar veprën El Ihtijar në një referencë të pazëvendësueshme për studiuesit lidhet me aftësinë e autorit për të ndërthurur në mënyrë koherente saktësinë e transmetimit doktrinar me një argumentim të qëndrueshëm dhe analitik të dispozitave juridiko-fetare. Kjo qasje metodologjike i ka dhënë veprës një thellësi konceptuale dhe qartësi të spikatur shkencore, duke e bërë atë bazë ndërtimore për shkollat hanefite ndër shekuj, si dhe burim autoritativ për çështjet e gjykimit, përgatitjes së fetvave dhe proceset e mësimdhënies.

Kjo vepër nuk përbën thjesht një përmbledhje të qëndrimeve të medhhebit, por një projekt shkencor

të kopsitur, i cili shpalos parimet themelore të tij, lidh në mënyrë sistematike çështjet dytësore me argumentet përkatëse dhe ofron mundësi për praktikimin e ixhtihadit të disiplinuar. Kjo qasje metodologjike ka bërë që vepra të pranohet gjerësisht në shumë departamente të shkencave islame, të shërbejë si burim referencë në hallkat e dijetarëve dhe të përdoret si manual bazë në shkollat e gjykimit islam në shumë rajone të botës myslimane.

Së dyti: Fikhu hanefi në vendet e Ballkanit

Prania e jurisprudencës hanefite në Ballkan shtrihet ndër shekuj, duke u konsoliduar që nga periudha e sundimit të Perandorisë Osmane në këtë hapësirë. Shkolla e mendimit Hanefi u përhap gjerësisht, dhe u konsolidua si themel i gjyqësorit, i përgatitjes së fetvave dhe i mësimdhënies; mbi parimet e tij u themeluan shkolla, u kodifikuan vendime gjyqësore në përputhje me të, dhe mbi këto themele u formuan breza të tërë dijetarësh dhe myftinjsh.

Ndikimet e kësaj shkolle mendimi janë ende të pranishme sot në strukturën e mendimit fetar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe pjesën tjetër të Ballkanit, ku jurisprudenca hanefite përfaqëson një referencë autentike që rregullon jetën e myslimanëve, rregullon transaksionet e tyre dhe drejton adhurimin



e tyre me një frymë të ekuilibruar, të hapur dhe me dhe disiplinë sistematike, karakteristike për këtë medhheb të madh.

Së treti: Rëndësia e përkthimit të librit El Ihtjar në gjuhën shqipe

Përkthimi i veprës El Ihtjar në gjuhën shqipe nuk përbën thjesht një transferim të tekstit nga një gjuhë në tjetrën, por është një punë qytetëruese që rivendos lidhjen e myslimanëve në këtë rajon me parimet themelore të medhhebit të tyre dhe trashëgiminë e tyre juridiko-fetare. Ky përkthim u mundëson studiuesve, studentëve, imamëve dhe predikuesve ta përdorin këtë burim në gjuhën e tyre amtare, duke e lehtësuar kuptimin, duke i afruar detajet shkencore dhe duke rritur vetëdijen e tyre mbi metodologjinë dhe argumentet e fikhut hanefi.

Ky përkthim gjithashtu plotëson një boshllëk shkencor që ka ekzistuar për dekada, pasi shumë nga veprat kryesore hanefite ende nuk janë përkthyer saktësisht në gjuhët ballkanike. Disponimi i përkthimit të librit El Ihtjar për lexuesin shqiptar përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e studimeve juridiko-fetare, zhvillimin e kurrikulave të edukimit islam, lehtësimin e qasjes në trashëgiminë e medhhebit dhe konsolidimin e identitetit shkencor të myslimanëve në këtë rajon.

Së katërti: Falënderime dhe vlerësime

Gjithashtu, nuk mund të lë pa theksuar këtu falënderimet dhe vlerësimet e mia të sinqerta për përkthyesit e nderuar të cilët kanë dhënë shumë nga koha, përpjekjet dhe dijet e tyre për të realizuar këtë përkthim të saktë. Ata kanë kryer një punë të madhe, e cila shtohet në historikun e shërbimit shkencor në Ballkan, kanë kontribuar në lidhjen e hallkave të dijes mes së kaluarës dhe së tashmes, dhe kanë shkruar emrat e tyre me germa të arta në shërbim të fikhut hanefi dhe trashëgimisë së umetit.

Gjithashtu, shpreh mirënjohjen time për institucionet akademike dhe autoritetet mbështetëse që kanë kontribuar në këtë projekt dhe e kanë mbështetur atë deri në realizimin e tij përfundimtar.

Në përmbyllje, i lutemi Zotit të Plotfuqishëm që ta bëjë këtë vepër të bekuar një hapësirë për projekte të tjera përkthimi, që i shërbejnë trashëgimisë tonë shkencore e kulturore, të udhëheqë profesorë, studiues dhe studentët e dijes për ta shfrytëzuar atë në mënyrë të dobishme, dhe ta bëjë këtë konferencë një pikënisje për aktivitete të ripërtërita shkencore në shërbim të medhhebit hanefi në veçanti dhe të shkencave islame në përgjithësi, duke forcuar praninë qytetëruese të Islamit në këtë rajon të lashtë të botës.

RRETH REDAKTIMIT DHE RECENSIMIT TË VEPRËS “EL INTIJAR”



Vepra madhore "El-ihthijar li ta'lil-il-muhtari" e cila tashmë është përkthyer në gjuhën shqipe falë kontributit të përbashkët e të vyer të tri bashkësive tona Islame, është një vepër e përmasave tejet të rëndësishme. Po ndaj në këtë artikull disa specifika të rëndësishme në lidhje me botimin dhe redaktimin e veprës së çmuar "El-Ihtijar li Ta'lilil-Muhtar", një prej teksteve më me ndikim në shkollën juridike hanefi.

E themi këtë me bindje të plotë, sepse jemi dëshmitarë të nevojës që kishin shqiptarët e pas komunizmit, për të ndjekur të argumentuar traditën shqiptare shekullore të Medhhebit Hanefi, teksa përballeshin me ndonjë shkollë tjetër të re juridike, të panjohur për ta, apo dhe me rryma ideore të ndryshme në drejtim të Jurisprudencës Islame.

Megjithatë, tashmë kemi nderin të prezantojmë punën jo pak të lehtë që është bërë për redaktimin dhe recensimin e kolanës "El-Ihtijar li Ta'lil-il-Muhtar". Kjo vepër, e cila shquhet për qartësinë metodologjike dhe thellësinë analitike, ka luajtur prej shekujsh një rol të pazëvendësueshëm në formimin e gjyqimit juridik dhe në shpjegimin e arsytimit të dispozitave fetare.

Procesi i redaktimit dhe i recensimit ka qenë një përpjekje e kujdesshme dhe e gjatë. U desh jo vetëm krahasimi me origjinalin, e përkthimit të bërë, por edhe harmonizimi i terminologjisë juridike me standardet bashkëkohore në gjuhën shqipe. Shpesh është dashur të sqarohen koncepte të thelluara juridike, të cilat kërkonin konsultime, në mënyrë për të ruajtur besnikërinë ndaj origjinalit, pa cenuar qartësinë për lexuesin e sotëm.

Kemi dhënë sugjerime të rëndësishme për saktësimin e punës së kryer, si për shembull: përpilimin e një indeksi, për dy arsye të veçanta:

Jo të gjithë lexuesit janë njohës të mirë të gjuhës arabe.

Shumë terma nuk janë të qartë edhe për arabfolësit, për arsye të ndryshimit të vetë termave gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe mungesës së përdorimit të këtyre termave në kohët tona, fjala vjen: (fuduli, kitabij, dhimi, bejun fasid, katlun muteamid, kefare, fasik,.... etj.).

Nga sugjerimet që kemi dhënë, ishte sqarimi në një ose më shumë paragrafë, apo në parathënie ose hyrje, përsa i përket dispozitave që aktualisht nuk praktikohen, si për shembull: rreth sklleverve, robërve të luftës, robinjave të luftës, ndarjes së plaçkës, llojeve të ndryshme të shitblerjeve, etj... të cilat në ditët e sotme nuk praktikohen dhe dalin si të pakuptimta, por si dispozita të fikhut është e domosdoshme që të citohen dhe sqarohen. Pra, për ta bërë të qartë se ato, pavarësisht se nuk gjejnë zbatim në ditët e sotme, janë të rëndësishme për kontekstin kohor në të cilin kanë ekzistuar, dhe,

në kohët moderne janë shembuj për atë realitet të mëparshëm.

Është bërë korrigjimi i gabimeve drejtshkrimore dhe gjuhësore, si dhe është unifikuar transkriptimi në një version sa më të përshtatshëm për gjuhën shqipe të fjalëve, si për shembull:

Nga All-llah - në Allah

Muhammed - Muhamed

Ebu Davud - Ebu Daud

Ajetet janë unifikuar gjatë redaktimit dhe për bazë është marrë versioni i Hasan Nahit.

Ndër sugjerimet që kemi dhënë është reduktimi në maksimum i ndarjes së fjalëve me apostrof apo vizë, si dhe unifikimi i shumë fjalëve, p.sh. "Imami, Juristi dhe muhadithi Abdullah Bin Mahmud El-Meusilij". Juristi është në shqip, muhadithi (dijetari i hadithit) në arabisht.

Përdorimi i vazhdueshëm i dubluar i termave në arabisht dhe në shqip duhet reduktuar në maksimum, si për shembull: fukahave-juristëve. Përdoret vetëm atje ku është e nevojshme.

Shumë prej termave nuk duhet të përkthehen aspak, sepse humb esenca, si për shembull: Hadith hasen është përkthyer hadith i mirë (mursel, daif, sahih, meudu, mudeles, garib, ahad,.... etj.), sugjerimi ka qenë që të mbeten në origjinal dhe të shpjegohen në indeks, në fillim ose në fund të librit.

Është bërë kujdes i veçantë për termat të cilat ëord-i i ndryshon në mënyrë automatike gjatë punimit në tekst, të cilat janë rregulluar nga ana jonë, si p.sh. (zekati-zukati; minberi-minderi; hutben-humben; kibles-kiles; akabe-arabe,..... etj.), të cilat duhen shikuar me kujdes, pasi ndryshojnë konceptin e fjalisë.

Gjatë redaktimit janë bërë edhe disa përmirësime, si për shembull:

Janë rregulluar gabimet dhe rëniet e shpeshta të emrave, fjalëve, fjalive dhe rreshtave në fusnotë e tekst, gjatë përkthimit.

Ka pasur raste të rralla kur është keqkuptuar fjalia dhe gjatë përkthimit është tjetërsuar dhe është nevojitur ndërhyrja, pas konsultimit me origjinalin, si p.sh. قَرِيبٌ رُبَلًا (i miri me mirësinë e tij) është përkthyer berberët (pra fiset berberë).

Këto shembuj që treguam janë vetëm një pjesë e punës sonë. Megjithatë, falë punës shumë vjeçare të ekipit dhe përkushtimit për t'i dhënë lexuesit shqiptar një material serioz dhe të standardizuar, sot kemi në dorë një botim që i shërben jo vetëm studiuesve, por edhe institucioneve fetare dhe akademike.

Së fundi, shpresoj që ky botim të jetë një nxitje për më shumë kërkim, përkushtim dhe bashkëpunim, në mënyrë që tradita jonë e pasur të vazhdojë të jetojë me dinjitet dhe t'i shërbejë shoqërisë sonë me urtësi.

01 IHTIJARI DHE ROLI I TIJ NË MENDIMIN JURIDIK ISLAM



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi konferencën me temë: “Ihtijari dhe roli i tij në mendimin juridik islam”.

Kjo konferencë u zhvillua në ambientet e “Tirana International Hotel”, me rastin e botimit të kolanës “El-Ihtijaru li Ta’lili-l-Muhtari”, botim ky i cili vjen si bashkëpunim ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Myftiu i Kosovës, H. Naim ef. Tërnavë, Kryetari i BFI-së në RMV, Reisul Ulema Shaqir Fetaj, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të të tre komuniteteve fetare, studiues, akademikë dhe ekspertë të jurisprudencës islame nga vendi dhe rajoni.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, theksoi rëndësinë e veprës “El Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr” si një nga burimet themelore dhe më autoritative të fikhut hanefi, duke vënë në pah vlerën e saj metodologjike, shkencore dhe historike në zhvillimin e jurisprudencës islame.

Ceremonia vijoi më tej me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Kosovës, H. Naim ef. Tërnavë, i cili e vlerësoi botimin në shqip të veprës “El Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr” si një ngjarje me rëndësi të veçantë shkencore dhe fetare për të gjithë besimtarët myslimanë të hapësirës shqiptolëse.





Ndërsa Kryetari i BFI-së në RMV, Reisul Ulema Shaqir Fetaj, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të tre komuniteteve fetare si jetike në misionin tonë të përbashkët të ruajtjes dhe përcjelljes së vlerave dhe normave tona fetare islame tek brezat e rinj, por edhe tek e gjithë ajo kategori që synon të thellohet në literaturën islame.

Pas përfundimit të fjalëve përshëndetëse, konferenca vijoi më tej me promovimin e veprës në fjalë nga z. Sabri ef. Bajgora, Bashkësia Fetare Islame e Kosovës, z. Mafiz Rustemi, Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe z. Dorian Demetja, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.



02 ZHVILLOHET SEANCA E PARË SHKENCORE



Pas përfundimit të seancës së përshëndetjeve, punimet e konferencës vijuan me seancën e parë shkencore, e cila u moderua nga Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Tauland Bica.

Kjo seancë u karakterizua nga trajtime të thelluara akademike dhe analiza metodologjike mbi veprën “El-Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr” dhe autorin e saj dhe solli një qasje shkencore të strukturuar, duke ndriçuar dimensionet juridike, teorike dhe praktike të veprës në kuadër të fikhut hanefi dhe mendimit juridik islam në përgjithësi.

Në këtë seancë, Dr. Elton Karaj trajtoi temën “Maksimat juridike në veprën el-Ihtijar të el-Meusiliut”, Dr. Ejup Haziri, temën “El-Ihtijar li ta’lili el-Muhtar: Një gur themeltar i jurisprudencës hanefite”, dhe z. Bledar Myftari, “El-Ihtijar si burim orientues për vendimmarrjen juridike islame”.

Seanca u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm shkencor, duke hapur rrugë për diskutime të mëtejshme dhe qasje të reja studimore mbi trashëgiminë juridike islame.



03 ZHVILLOHET SEANCA E DYTË SHKENCORE



Pas përfundimit të seancës së parë shkencore, punimet e konferencës vijuan me seancën e dytë dhe të fundit shkencore, të cilën e moderoi Nënkrjetari i Institucionit, z. Lauren Luli.

Kjo seancë u karakterizua nga trajtime të thelluara akademike dhe qasje bashkëkohore mbi veprën "El-Ihtijar li Ta'ili-l-Muhtâr".

Në këtë seancë, Dr. Xhemal Seferti trajtoi temën "Vepra El-Ihtijar në jurisprudencën hanefite: një pasqyrë e shpirtit të medhhebit dhe e shumëllojshmërisë së shkollave të tij", ndërsa Prof. Dr. Abdulxhemil Nesimi, trajtoi temën "Vlera shkencore dhe pedagogjike e veprës El-Ihtijar në mësimdhënien e jurisprudencës islame".

Më tej, Dr. Ana Gjeci, përmes temës "Një rilexim i El-Ihtijar li ta'ili el-Muhtar si urë mes tekstit dhe kontekstit", solli një lexim analitik që evidentoi aktualitetin dhe fleksibilitetin interpretues të veprës në raport me realitetet shoqërore dhe juridike.

Seanca u përmbyll me kumtesën e z. Eduart Shefkiu, "Metodologjia e arsyetimit juridik në veprën El-Ihtijar li ta'ili el-Muhtar".

Kjo seancë e fundit e konferencës u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm shkencor, duke thelluar diskutimin akademik dhe duke hapur horizonte të reja studimore mbi trashëgiminë juridike islame.



IBN SINA: GJUHA E FESË DHE INTERPRETIMI “FILOZOFIK” I KUR’ANIT



Ebu Ali el-Husejn ibn Abd Allah Ibn Sina njohur në perëndim si Avicena (970-1037) ishte filozofi dhe mjeku më i shkëlqyer i botës islame. Ai, përveç që ishte filozof i madh pothuajse ishte po aq i madh edhe si shkencëtar edhe si mjek. Në të vërtetë ky në Perëndim më tepër njihet si mjek dhe ekspert në mjekësi. Fotografia e tij si princ i mjekëve i stoliste muret e shumë katedraleve nëpër Evropë, ndërsa Dante Aligjeri i shprehu nderim duke e vënë në purgator në mesin e dy autoriteteve më të njohur antikë, në mesin e Hipokratit dhe të Galenit. Edhe në Lindje ndikimi i tij si mjek vazhdimisht dominoi dhe si i tillë mbeti deri më ditët e sotme.

Ai dominoi jetën intelektuale në botën islame për shekuj me radhë, dhe gjithfarë reagimesh ndaj

tij, që variojnë nga pranimi deri te rishikimi apo refuzimi, të cilat përcaktuan zhvillime në filozofi, shkencë, teologji dhe misticizëm. Në përkthimin latin, duke filluar në shekullin e dymbëdhjetë, filozofia e Ibn Sinas influencoi fuqishëm filozofët dhe dijetarët e mesjetës dhe Rilindjes, sikundërse përkthimi latin i veprës së tij mjekësore Kanoni, shpeshherë i rishqyrtuar, formësoi bazën e udhëzimit mjekësor në universitetet europiane deri në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Me ndikimin e tij në historinë intelektuale në lindje dhe në perëndim, në lindje ka marrë titullin “esh-Shejh er-Reis”, “Mjeshtëri më i Shkëlqyer”, ndërsa në perëndim “Princi i Mjekëve”.

Veprat kryesore filozofike të Ibn Sinas nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe, përveç disa

pjesëve nga Shërimi (el-Shifa) dhe veprës alegorike Hajj bin Jakdhan. Shkrimet e Avicenës, në pamjen e strukturës dhe gamës së objekteve të tyre, këto përmbledhje i përkasin traditës neoplatoniko-aristotelike, e cila emërtohet si Meshai apo peripatetike. Kjo shkollë filozofike, ku si përfaqësues në Lindje kishte al-Kindin, Farabin dhe Ibn Sinan, ndërsa në Perëndim Ibn Rushdin, përpiket të harmonizojë filozofinë greke me fenë Islame (revelatën) dhe zhvilloi një sistem filozofik të bazuar në arsyetim, logjikë dhe prova. Duhet theksuar se në Lindje, pas Ibn Sinas, nuk pati njeri më interes dhe nevojë të mëtej drejtpërdrejt me Platonin dhe Arsitotelin. Studjuesi e filozofisë cdo gjë mund ta gjente në librat e Ibn Sinas, pasi ai i përmbledhoi dhe trajtoi të gjitha shkencat e kohës në librat e tij.

Figura e Profetit dhe Gjuha e Fesë

Ibn Sina nuk ka shkruar ndonjë vepër të veçantë për ta trajtuar çështjen e fesë, por e lidh fenë me figurën e Profetit, i cili gjendet në një pozitë për të legjisluar dhe rregulluar jetën sociale. Subjektet e tërë pjesëve të filozofisë praktike mbulohen shkurtimisht në fund të veprës Shërimi, Metafizika. Ibn Sina e shikon si të domosdoshme ekzistencën e Profetit dhe këtë e lidh me idenë e mirësisë dhe ndihmës hyjnore. Sipas tij, përkrahja dhe ndihma hyjnore, e cila është garantuesja e vazhdimësisë së rregullit të mirësisë në univers, mundëson edhe “të mbijë vetulla mbi sy ose shputa e këmbës të jetë e lakuar, gjëra të cilat nuk janë të domosdoshme për vazhdimësinë e jetës së njeriut”. Atëherë, është e pamundur që përkrahja dhe ndihma hyjnore, të mos e bëjë të domosdoshme ekzistencën e Profetit, i cili është “i domosdoshëm” për vazhdimin e ekzistencës së individit dhe shoqërisë. Pasi nevoja për Profetin e njeriut, për ekzistencën dhe vazhdimësinë e llojit të tij, është më e madhe se sa shumë gjëra të tjera.

Profeti e arrin shkallën e intelektit të shenjtë (akli kudsijje), i cili të gjitha njohuritë i merr drejtpërsëdrejti nga intelekti veprues (aklu faal), befasisht dhe pa kurrfarë përgatitjesh paraprake. Në këtë mënyrë, përnjëherë informohet për çdo gjë nga e kaluara, nga e tashmja dhe nga e ardhmja.

Në mënyrë që feja të vendoset me të gjitha dimensionet e saj në shoqëri, nuk mjafton vetëm të pranohet se ajo përfaqëson të vërtetën dhe të mirën, por njëkohësisht ajo duhet edhe “të kuptohet”. Për këtë arsye, të vërtetat që kumton feja janë të detyrueshme të përcillen në një

gjuhë që e kupton i gjithë populli. Kjo gjuhë, përtej paraqitjes së fesë në gjuhët arabisht dhe hebraisht, tregon për një veçori të fesë universale, të cilën Avicena e emërton qartësisht si “gjuha e fesë”.

Veçoria kryesore e kësaj gjuhe fetare, e cila është ndër problemet themelore të Filozofisë së Fesë në ditët tona, sipas Ibn Sinas, qëndron pikërisht në strukturën e saj simbolike dhe metaforike. Kështu që, disa të vërteta që njerëzit në përgjithësi nuk mund t’i kuptojnë, do të përshtaten në një gjuhë që ata mundën ta kuptojnë dhe në këtë mënyrë do të lehtësohet ngulitja e të vërtetave në mendjet e tyre. Thënë ndryshe, nëpërmjet analogjive dhe simboleve të realizuara nga gjuha e fesë, njerëzit do të afrohen më shumë me të vërtetat, nisur nga ato që kuptojnë, të arrijnë ato që nuk i kuptojnë. Natyrisht që Zoti, i Cili është burimi i çdo mirësie, sipas tij, vlerëson atë që është më e mira për njerëzit në këtë drejtim. Për këtë arsye, “nuk ka ndonjë problem që mesazhi i Tij të përfshijë një numër shenjash dhe simbolesh që u drejtohet atyre që janë krijuar të prirë për të bërë një hetim filozofik”, thotë ai.

Ibn Sina mendon se përmbajtja simbolike e fjalës së Profetit dhe gjuhës së fesë është kusht nga ana shoqërore. Për shembull, kur njerëzve u prezantohen çështje themelore të fesë si Zoti, atributet e Tij dhe jeta pas vdekjes, theksohet nevoja e përdorimit të disa simboleve dhe metaforave, të përbëra nga kuptimet e njohura prej njerëzve. Në të njëjtën mënyrë, kur shpjegohet fuqia dhe madhështia e Zotit do të përdoren shembuj, simbole dhe kuptime metaforike që tregojnë fuqinë dhe madhësinë sipas njerëzve. Edhe kur shpjegohet jeta pas vdekjes, si metodë, do të përdoren shembuj në gjëra të cilat njerëzit mund t’u imagjinojnë formën dhe të jenë të preferuara për t’u rrënjësuar në zemrën e tyre, ndërsa për shpërblimin dhe dënimin, të jenë shembuj që njerëzit i kuptojnë dhe i konkretizojnë në mendjen e tyre.

Sipas Ibn Sinas, feja, nuk është në gjendje t’ia paraqesë disa të vërteta themelore me gjithë lakuriqësinë dhe abstraktin e tyre të vërtetë masës së njerëzve të përbërë nga të gjithë nivelet, pasi ata nuk do ta kuptonin. Duke mos arritur ta kuptojnë, ata do të hynin në dyshime dhe duke e bërë këtë do të shkonin deri në mohim. Mirëpo, kjo situatë është diçka që Profeti duhet ta shmangë, pasi qëllimi i tij është që të kuptohet. Prandaj feja, ua ka përcjellë njerëzve mesazhin në një gjuhë kryesisht metaforike. Në fakt, shumica e shpjegimeve dhe

përshkrimeve në Kur'an lidhur me shpërblimin dhe ndëshkimin e botës tjetër, janë paraqitur krejtësisht në një mënyrë simbolike dhe për këtë arsye, shumica e njerëzve pandehin se Bota e Përtejme është vetëm lëndore, gjë që në fakt nuk është një kuptim i saktë. Ashtu si me çështjet e tjera fetare, edhe kjo formë simbolike dhe metaforike e shpjegimit këtu, është një metodë e saktë, sepse nëse jeta e përtejme do të përshkruhej shpirtërisht dhe jo fizikisht, nuk do të ishte e mundur që mendjet t'i kuptonin me të parën këto të vërteta. Në këtë rast, pra, nuk do të kishin kuptim thirrjet apo ndalesat e feve. Për këto arsye, feja ka përdorur tregimin simbolik, duke synuar që njerëzit të afrohen më shumë me kuptimet e saj të vërteta.

Nga e gjithë kjo kuptojmë se, nuk është e mundur që për çdo çështje të pranohet si argument kuptimi i fjalëpërfjalshëm (literal) i fesë. Përndryshe, do të duhet të pranojmë disa çështje që janë të papranueshme dhe të shëmtuara. Përveç kësaj, nëse kuptimi i simboleve të përdorura nga Profeti nuk kuptohet, kjo e bën të pamundur kuptimin e realitetit të sferës hyjnore. Prandaj, ajo që duhet bërë është që, simbole të tilla të analizohen nga specialistët, si dhe të zbërthejnë kuptimet e tyre të vërteta, e thënë ndryshe, t'i interpretojnë ato. Në këtë kontekst, shihet se Avicena interpretoi shumë vargje kuranore dhe i komentoi ato në mënyrë filozofike.

Tefsiri Filozofik i ajetit të Sures Nur

Ibn Sina nuk ka shkruar një tefsir të mirëfilltë Kur'ani, por ka bërë interpretime të disa sureve dhe ka përdorur ajete kuranore për të argumentuar konceptet e tij filozofike. Ndër trajtesat (risale) e tefsirit që Ibn Sina ka shkruar, mund të përmenden Tefsiru Sureti'l-Ihlas, Tefsiru Muauhidetejn, Tefsiru Ajeti'd-Duhan, Tefsiru Sureti'l-A'la, er-Risaletu'n-Nevruzijje (Tefsiri i Hurufu Mukattaa) dhe Tefsiru ajeti'n-Nur.

Duke u nisur nga botëkuptimet e tij filozofike¹, Ibn Sina bën në mënyrë të detajuar interpretimin filozofik të ajetit 35 të Sures Nur, në Kuranin Famëlartë, ku thuhet: "Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës. Drita e Tij shëmbëllen me atë të një kamareje, në të cilën ndodhet një llambë. Llamba është në një kristal, kurse kristali është si një yll i shndritshëm. Ajo (llamba) ndizet nga druri i bekuar i ullirit, as lindor, as perëndimor, ndërsa vaji i saj shkëlqen edhe pa e prekur zjarri. Dritë sipër dritës. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij që të dojë dhe paraqet shembujt për njerëzit. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë."

Të qenurit dritë e Allahut, do të thotë se në qënien e tij është i mirë dhe është shkaku i të gjitha të mirave. Me shprehjen "e qiejve dhe e Tokës" përfshin të gjitha qëniet ekzistuese. Me fjalën "Kamare" (zgavra në mur ku vendoset llamba) ka për qëllim intelektin material (të papërpunuar, potencial) ose në

1. Në filozofinë e Ibn Sinas llojet e intelektve dhe lidhja e tyre me intelektet kozmike zënë një vend të veçantë. Sipas Ibn Sinas, shkalla më e ulët është (1) Aklul bil'kuvvve/hejulani **العقل بالقوة او العقل الهولاني** (intelekti material / potencial), që është fuqi dhe aftësi materiale për arritjen e diturive dhe këtë e kanë të gjithë njerëzit. Pas kësaj, meqë njeriu i arrin parimet themelore të diturisë dhe ngadhënjën përmes mendimit të shëndoshë, arrin në shkallën tjetër (2) Aklul bil'fiil **العقل بالفعل** (në intelektin e aftësive) dhe, nëse ec edhe një hap para dhe bëhet i aftë për t'i arritur vetë dituritë dhe për ta vënë vetë në lëvizje veprimin intelektual të tij, do ta arrijë shkallën (3) Aklul mustefad **العقل المستفاد** (e intelektit veprues). Dhe në fund, shkalla më e lartë deri ku mund të ngjitet njeriu, duke mos i pasur parasysh Profetët, të cilët, falë përsosshmërisë së plotë të natyrës së vet gëzojnë status të veçantë, është (4) Aklul Kudsij **العقل القدسي** (intelektit të shenjtë), në Otë cilën me anë të njeriut realizohet ekzistenca e universit dhe ku njeriu bëhet mostër e botës intelektuale. Përmbi të gjitha shkallët e intelektit gjendet (5) Aklul Faal **العقل الفعال**, intelekti universal apo veprues, që është intelekt i dhjetë kozmik. Nëpërmjet të ndricimit nga ky intelekt përfitohen të gjitha dituritë dhe me këtë intelekt në shkallën e vet më të lartë bashkohet intelekti njerëzor.

kuptimin e përgjithshëm shpirtin racional (nefsi natik) ². Sepse, duke qenë se muret e kamares janë shumë afër me njëra-tjetrën e pasqyrojnë më fort dritën dhe nëse intelektin e aftësive e përngjasojmë me dritën, vendi më i përshtatshëm për pasqyrimin e kësaj drite mund të themi së është intelektu material ose shpirti racional.

Në këtë rast, lidhja e (1) intelektit material/potencial me (3) intelektin veprues është si lidhja mes kamares dhe dritës. "Llamba" në këtë rast përkon me intelektin veprues. Kështu që ambjenti i ndricuar është si rezultat i dritës që kalon nga gjendja potenciale në atë aktive. Prandaj lidhja mes (1) intelektit material/potencial me (3) intelektin veprues është si lidhja mes kamares dhe dritës. Ndërsa "kristali" përkon me shkallën mes (1) intelektit material/potencial dhe (3) intelektin veprues që i bie (2) intelektit i aftësive. Niveli i intelektit transparent që mundëson hedhjen e dritës, mbledhjen dhe pasqyrimin e saj përfaqësohet me "kristali është si një yll i shndritshëm" dhe jo me turbullirën. "Druri i bekuar i ullirit" nënkupton forcën intelektuale (el-kuvvet'ul-fikrijje). Sepse kjo forcë është lënda e veprimeve intelektuale. Mos lidhja e kësaj lënde as me lindjen dhe as me perëndimin, ku thuhet "as lindor, as perëndimor", sipas Ibn Sinas kjo është një detaj i hollë ku tregon se sa me vend është metafora. Lindje do të thotë "vendi nga vjen drita", ndërsa Perëndim "vendi ku humbet drita". Në këtë rast theksohet se forca intelektuale nuk lidhet as me vendin ku ndodh ndricimi, që është veprimi intelektual dhe as me vendin ku nuk ka ndricim, që është forca e shpirtit animal (shtazor). Sepse forca intelektuale, nuk i përket as fuqisë së shpirtit racional (d.m.th. Lindjes) fuqisë së shpirtit

2. Ibn Sina, duke u nisur nga tradita aristoteliane dallon tre lloje shpirtërash si dhe aftësitë e tyre. Shpirtin vegjetativ, ku bëjnë pjesë bimët, Shpirtin shtazor ku bëjnë pjesë kafshët dhe Shpirtin racional ku bën pjesë njeriu. Cdo shpirt ka aftësinë dhe veçoritë e tij.

animal (d.m.th. Perëndimit). Në shprehjen "Vaji i saj shkëlqen edhe pa e prekur zjarri", sipas tij këtu lëvdohet fuqia intelektuale, ndërsa me "prekjen e zjarrit" ka për qëllim "bashkimin" me intelektin universal. Sepse zjarri këtu, përfaqëson dritën e vërtetë, që është (5) Aklu Faal (intelekti universal apo veprues).

Kritikat e Imam Gazaliut

Ndikimi i Avicenës ishte i madh. Megjithatë në botën perëndimore, ashtu si me Averroesin, nuk është parë ndonjë "Avicenizëm latin", përsëri është i qartë ndikimi i Avicenës. Një nga debatet më të mëdha të averroizmit në Evropë gjatë mesjetës ishin mbi mendimet e Ibn Rushdit, për të vërtetën fetare dhe atë filozofike. Argumentin kryesor që Ibn Rushdi përdor, teorinë e dy të vërtetave siç njihet në Evropë, në fakt është vazhdimësia e gjuhës fetare dhe interpretimit të Ibn Sinas. Mirëpo asnjëri nuk mendonte se ka dy të vërteta (fetare dhe filozofike); e vërteta është një, ajo është e vërteta filozofike, ndërsa ajo fetare është një lloj përshtatje e saj, për t'u kuptuar nga shumica e njerëzve.

Pikërisht, në çështjen e interpretimit të gjuhës së fesë dhe jetës pas vdekjes nga Ibn Sina në lidhje me formën e saj, duke thënë se ajo do të jetë shpirtërisht dhe jo fizikisht, ai mori kritika të rënda nga Imam Gazali. Më tepër se kritika filozofike ato ishin akuza se ai kishte vepruar "kufr", veprim pra që e nxjerr nga feja. Nga tri çështje për të cilat ai i bëri "tekfir", njëra prej tyre kishte të bënte me abstragimin e ringjalljes fizike në Ahiret dhe interpretimin e gjuhës fetare. Këtyre akuzave iu përgjigj më pas Ibn Rushdi, duke mbrojtur pozicionin e filozofëve. Sipas tij, në çështje të tilla interpretimi, nuk mund të akuzohet dikush për dalje nga feja (kufr). Pra, ai e quan si të tepruar "tekfir"-in e Imam Gazaliut, por jo të padrejtë si kritikë.

Besimtari mes durimit dhe falenderimit

Të nderuar besimtarë! Sot ndajmë me ju një temë e cila është aktuale për secilin besimtar dhe brenda saj përfshihet çdo aspekt i jetës sonë. Bëhet fjalë për gjendjen e besimtarit, i cili sillet vazhdimisht mes durimit dhe falënderimit.

Suhejb ibnu Sinan (r.a.) transmeton se Profeti (s.a.s.) ka thënë: "Çështja e besimtarit është e habitshme. Në fakt, e gjithë çështja e tij është mirësi. Kjo i ndodh vetëm besimtarit. Nëse i vjen një e mirë, ai falenderon dhe kjo është mirë për të. Nëse e godet një e keqe, ai duron dhe kështu është mirë për të."

Në këtë hadith tregohet në mënyrë të qartë vlera e jashtëzakonshme që kanë durimi dhe falenderimi. Nëse një besimtar i kultivon këto dy cilësi te vetja, ai do të korrë sukses në çdo aspekt të jetës. Këtu na tregohet qartë sjellja e besimtarit përballë mirësive dhe vështirësive, dhe me anë të këtij qëndrimi dinjitoz dhe korrekt ai arrin të fitojë mirësinë në këtë botë e në Ahiret (botën tjetër).

Pavarësisht se këtu përcaktohet durimi ndaj fatkeqësieve dhe falenderimi ndaj mirësive, ndonjëherë kjo e fundit mund të jetë një provë më e rëndë sesa vetë fatkeqësitë. Prandaj është thënë se besimi ndahet në dy gjysma të barabarta, ku njëra gjysmë është durimi dhe tjetra falenderimi. Kështu, në këto dy cilësi përmbledhet e gjithë feja për besimtarin.

Kuptimi i falënderimit dhe vlera e tij

Falenderues është ai njeri që çdo mirësi ia atribuon Zotit të Tij, duke pranuar se ato i gëzon falë bujarisë së Krijuesit dhe kështu veçse afrohet më shumë me Të. Allahu thotë në Kuran:

وَمَا بِكُمْ مِّنْ نِّعْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ

"Çdo mirësi që keni është nga Allahu." (Nahl, 53)

Cilësia e të falenderuarit është një lloj kriteri dallues për përmirësimin e njeriut në zemrën, gjuhën dhe gjymtyrët e tij, sepse pikërisht me të gjitha këto ai kryen falënderimin për çdo mirësi.

Megjithatë, sado të falënderojë njeriu e të tregohet

mirënjohës, ai kurrë nuk arrin dot të përmbushë falënderimin e plotë, qoftë edhe për një mirësi të vogël, sepse brenda saj fshihen pafundësisht mirësi të tjera. Por Allahu, me mirësinë e Tij, e pranon falënderimin e krijesave dhe premtan shpërblim të madh, sidomos për ata që falënderojnë në çdo gjendje.

Omeri (r.a.) dëgjoji një njeri të lutej vazhdimisht në Qabe duke thënë: "O Allah, më bëj pjesë të robërve të Tu të paktë!" I çuditur, e pyeti: "Çfarë kuptimi ka kjo lutje?" Personi iu përgjigj: "A nuk e ke lexuar fjalën e Allahut ku thotë: وَقَلِيلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّاكِرُونَ"

"Megjithatë, pak nga robërit e Mi janë falënderues." (Sebe', 13)

Falënderimi i vërtetë, pas atij që shfaqet në gjuhën tonë, është padyshim ai që manifestohet me vepra, duke i përdorur mirësitë e Allahut në rrugë të mbarë. Nëse ndodh e kundërta, atëherë nuk jemi duke falënderuar, por po i shpërdorojmë ato kundër vetes sonë. Kështu na bëhet e qartë që falënderimi s'duhet të mbetet në gjuhë, por të reflektojë në vepra. Besimtari thotë: "Elhamdulillah" për çdo mirësi që i ka ardhur, për çdo mirësi që përjeton në atë çast dhe për çdo mirësi që do të vijë.

Profeti (s.a.s.) u pyet për namazin e tij të natës, pasi ishte falur aq gjatë saqë i ishin enjtur këmbët, dhe ai tha: أَفَلَا أَكُونُ عَبْدًا شَكُورًا

"A të mos jem një rob vazhdimisht falënderues?"

Garancia e vetme për vazhdimësinë dhe shtimin e mirësive mbetet sërish falënderimi. Kjo gradë qëndron mbi durimin dhe mbi të qenit i kënaqur me caktimin, sepse me vullnet të lirë njeriut i mbushet zemra dhe është thellësisht mirënjohës për çdo mirësi.

Kuptimi i durimit dhe vlera e tij

Mahnitja e Profetit (s.a.s.) me gjendjen e besimtarit edhe kur ai duron, tregon qartë se sa thesar i pashtershëm është ai. Për më tepër, fryti i durimit që na tregohet në këtë hadith dhe synimi i tij i lartë është të fituarit e kënaqësisë, faljes dhe



shpërblimeve të Allahut. Nëse është kështu, atëherë përse të mos shfaqë një besimtar durim të hijshëm?

Durimi është përkufizuar si vetëpërmbytje ndaj rënies në pesimizëm e zemërim, si dhe vetëpërmbytje e gjuhës ndaj fjalëve që shfaqin pakënaqësi ndaj Zotit. Po ashtu, edhe gjymtyrët tona janë gjithmonë nën kontroll dhe nuk veprohet nën ndikimin e zemërimit. Disa të tjerë kanë thënë se durimi do të thotë të qëndrosh përballë fatkeqësisë me edukatë të lartë.

Durimi ndahet kryesisht në tre lloje:

1. Durimi në adhurim dhe kryerjen e tyre vazhdimisht, qoftë të detyrueshme apo të pëlqyeshme.
2. Durimi ndaj mëkatit, duke e braktisur dhe duke mos rënë në të.
3. Durimi ndaj caktimit të Allahut, që përfshin sprovat dhe fatkeqësitë.

Këto fatkeqësi mund të duken të hidhura nga jashtë, por në brendinë e tyre gjenden të mira të shumta. Nëse rob duron ndaj tyre dhe thellohet në përpjekjen për t'i kuptuar ato, ai lartësohet drejt gradës së falenderimit, dhe kështu vështirësitë i shndërrohen në mirësi.

Durimi ka vlera të shumta dhe mes tyre mund të përmendim:

Allahu ka urdhëruar për të dhe ne i bindemi urdhrit të Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ

"Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz!" (Bekare, 45)

Allahu i lavdëron të duruarit: الصَّابِرِينَ وَالصَّادِقِينَ

"Që janë të durueshëm, të sinqertë." (Ali Imran, 17)

Allahu i do të duruarit: وَاللَّهُ يُحِبُّ الصَّابِرِينَ

Dhe shpërblimi i tyre është i pamasë:

إِنَّمَا يُوفَى الصَّابِرُونَ أَجْرَهُمْ بِغَيْرِ حِسَابٍ

"Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë." (Zumer, 10)

Për çdo adhurim në Islam gjendet një shpërblim i përcaktuar dhe i kufizuar, përveç durimit. Sa njerëz ka që kalojnë testin

e fatkeqësive dhe nuk kalojnë dot testin e mirësive! Abdullah b. Mes'udi ka thënë: "Besimtari sillet ndërmjet dy gjendjeve: mes falënderimit ndaj mirësive dhe durimit ndaj fatkeqësive."

Vetë bindja e besimtarit se çdo gjë është prej Allahut bën që ai të shohë të mirën brenda tyre, dhe një bindje e tillë e ndihmon të shfaqë sa më shumë durim. Gjithashtu, duhet kuptuar se jo çdo gjë që vjen prej Allahut është ndëshkim; përkundrazi, ato janë sprova përmes të cilave provohemi, e kush duron, do të fitojë shpërblim të madh.

Ky hadith profetik konsiderohet thelbësor në çështjet e besimit. Nëse njeriu e mbush zemrën me besim, atëherë rrok lumturinë, qetësinë dhe kënaqësinë përgjatë jetës së tij. Gjendjet e tij sillen mes lehtësisë dhe vështirësisë, mes sëmundjes dhe shëndetit, mes sikleteve dhe çlirimit prej tyre. E nëse ekziston besimi, atëherë gjendet çdo e mirë, përndryshe njeriu privohet nga çdo lloj mirësie. Falënderimi dhe durimi janë dy cilësi që Islami i nxit në mënyrë të jashtëzakonshme, madje urdhëron për to.

Ndërsa jobesimtari është e kundërta e kësaj. Nëse i ndodh një e mirë, ia atribuon vetes dhe largohet nga adhurimi i Zotit, duke u përpjekur ta shijojë sa më shumë atë mirësi, dhe kështu mashtrohet prej saj. Po ashtu, në gjendje fatkeqësie ai nuk përmbahet, zemërohet, bota i ngushtohet dhe një gjendje pikëllimi e shoqëron gjithë jetën.

Le të largohemi nga këtu me bindjen se jeta e besimtarit ndërtohet mbi durim dhe falënderim. Këto dy shtylla e mbrojnë zemrën dhe e drejtojnë njeriun në çdo gjendje. Le të kërkojmë nga Allahu që t'i forcojë tek ne këto cilësi dhe të na udhëheqë drejt veprave që Ai i do.

Allahu na bëftë prej atyre që jetojnë me besim dhe përkushtim! E lusim Allahun të na japë durim përballë sprovave dhe të na bëjë falënderues në çdo gjendje tonën! Amin!

GRUAJA MYSLIMANE

dhe sfidat e botës moderne

Figura e gruas në Islam

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për mënyrën se si përshkruhet femra myslimane në media, e sidomos në ato perëndimore. Figura e përbashkët, që gjendet nëpër artikuj të ndryshëm, është ajo e stereotipit të femrës, që fshihet pas një mbulese, një femër pa zë, një figurë e heshtur, e privuar nga të drejtat e saj. Islami, si fe universale, ka gjetur përhapje në zona të ndryshme gjeografike të botës, ku është praktikuar sipas kushteve specifike të çdo kombi apo shteti. Duhet theksuar se Islami është, në fakt, më shumë se një emër, se një fe, se një lëvizje shoqërore. Islami është të njohurit e esencës së të shenjtës kudo, pa njohur kohë, çmim, përtej kulturash, traditash dhe gjithë kufizimeve njerëzore.

Pozita e gruas para Islamit

Islami lindi dhe lulëzoi në Gadishullin Arabik, në një periudhë që daton para më shumë se 1400 vitesh. Në atë kohë, përveç Arabisë, ekzistonin edhe kombe e kultura të tjera. Në periudhën pre-islame, në kulturën fisnore të arabëve, femra nuk ishte e barabartë me mashkullin në shumë kushte shoqërore, individuale dhe nëpër sisteme të ndryshme, përkatësisht martesë, trashëgimia dhe arsimi, midis të tjerash. Femra nuk gëzonte asnjë lloj prone apo të drejte ligjore. Ishte koha kur foshnjat femra të sapolindura varroseshin të gjalla, sepse konsiderohej turp rritja e atij fëmije. Pozita e gruas në shek. VII, përveçse në Arabi, nuk ishte e ndryshme edhe në kombe të tjera. Përçmimi dhe ulja e figurës femërore ishte kthyer në trendin e atij shekulli. Në Evropë, përkatësisht në Francë, grua arriti të fitonte të drejtën e shitblerjes së pronës pa lejen e bashkëshortit, jo më herët se shekullin e kaluar, pra 13 shekuj më vonë nga periudha në fjalë. Në shumë shtete, djemtë gëzonin të drejtën e trashëgimit të emrit, të pasurisë, ndërsa për femrat

shpresohej që të martoheshin në derë të pasur. Në shumë vende, perëndimore dhe lindore, femrat nuk kishin të drejtën e zgjedhjes së partnerit të tyre; veçshat ishin të detyruara të mbanin zi deri në fund të jetës së tyre, fenomen ky i hasur shpesh edhe në ditët e sotshme në Shqipëri.

Standardet e vendosura prej Islamit

Askush nuk mund të përkufizojë si duhet apo të theksojë mjaftueshëm influencën e ajeteve kur'anore dhe mësimave të Profetit a.s. për zhvillimin e civilizimit. Në historinë njerëzore nuk njihet tjetërkush që të ketë punuar aq shumë për të mbrojtur të drejtat njerëzore në përgjithësi dhe ato të femrës në veçanti, me një integritet të tillë, me një forcë dhe strategji gjeniale. Profeti i Islamit arriti të mbronte të bukurën dhe hyjnore, të nderonte njerëzimin duke e çliruar prej zinxhirëve të paragjykit, manipulimeve dhe padrejtësisë personale e shoqërore. Mësimet e tij për edukimin, arsimin, të drejtat politike dhe shoqërore, të drejtat e pronës dhe të drejtat e njeriut në mënyrë absolute, janë ndër kapitujt më me vlerë në librin e civilizimit. "Kërkimi i dijes është një detyrë e çdo myslimani, burrë e grua" - thotë Profeti a.s. Me këtë udhëzim të tijin, edukimi i vetvetes, i familjes dhe shoqërisë, u bë një detyrë fetare, saqë askush nuk mund të privonte asnjë genie njerëzore prej ndjekjes dhe mësimi të dijes. Gjinia apo raca, kultura apo tradita, nuk u bënë shkak ndalimi për arsimimin dhe edukimin e individit. Për më tepër, mësimi dhe ndjekja e dijes u bë një ligj fetar, rrjedhimisht i domosdoshëm për t'u zbatuar. Kësisoj, Profeti Muhamed a.s. formoi jo vetëm të drejtën e barabartë për edukim, por gjithashtu hapi dyert drejt botëkuptimit sa më të mirë. Nëse do të ndaleshim tek e drejta politike dhe sociale, do theksonim fillimisht fjalën e Profetit a.s.: "Xheneti shtrihet nën këmbët e nënave". Me këtë udhëzim, respektimi dhe nderimi i gruas u bë një përgjegjësi fetare, një akt



i lavdërueshëm. Në libra historie hasim rolin e gruas në kohën e Profetit a.s., dallon qartë pjesëmarrja e saj në luftë, e drejta e konsultimit me të Dërguarin e Allahut dhe e drejta e votës. Pra, gruaja merre pjesë në çështje sociale, politike, madje edhe ushtarake. Si rezultat i këtyre mësimëve, nuk përkraheshin vetëm të drejtat njerëzore, por inkurajohej gjithashtu edhe vetë individi që të ishte në gjendje t'i dilte vetes për zot. Fatimja r.a., vajza e Profetit tonë, ishte shumë mirë e edukuar dhe shumë e respektuar prej të gjithëve. Thuhet se, sa herë që ajo hynte në dhomë, Profeti a.s. i lëshonte vendin. Sakrificat e saj për të mbrojtur dhe mbështetur të drejtat e njerëzve, konsiderohen ndër aktet e saj më në zë, më të lavdishme.

E drejta e pronës në ligjin islam

Femra fitoi të drejtën për të blerë dhe shitur prona, fitoi të drejtën e të pasurit një biznes, një aktivitet personal, fitoi të drejtën të ndërmerre veprime ligjore, të votonte dhe të merre pjesë në çështje politike. Trashëgimia ishte një ndër të drejtat më kryesore. Ishin këto ligje që i lejuan asaj edhe pretendimet e prikës paramartësore. Pas martesë femra gëzon çdo të drejtë mbi prikën e saj, madje pas divorcit, ajo merr edhe pjesën e saj legjitime të pronës.

Martesa dhe e drejta e divorcit

Sipas ligjit islam, femra dhe mashkulli gëzojnë të drejtën e zgjedhjes së partnerit dhe ata nuk mund të detyrohen prej askujt për të kryer këtë akt, pa pëlqimin e tyre vetjak. Kur Aliu r.a., prijësi i besimtarëve, kërkoi dorën e vajzës së Profetit a.s., Fatimes, përgjigjja nuk iu dha menjëherë, por pasi ishte marrë në konsideratë mendimi i vetë asaj. Divorci është i lejuar, gjithmonë në kushte të caktuara dhe me një shkak përfundimtar. Për të justifikuar paragjykimin, dëmtimin, cenimin e gruas, ne mund të fajësojmë një religjion, një kulturë, ndoshta një sistem, ose

edhe vetë gruan, por, të gjitha këto justifikime sipërfaqësore, "që të bëjnë të ndihesh i lehtësuar", nuk e largojnë barrën e përgjegjësisë prej gjeneratës njerëzore. Nga ana tjetër, është e vërtetë që media mashtron njerëzit, udhëheqësit politikë po ashtu, madje edhe ideologji sipërfaqësore e bëjnë këtë: pra, njerëzit mbeten të keqinformuar, të manipuluar, të kequdhëhequr për të mësuar rrjedhën e vërtetë të ngjarjeve, por marrin të gatshme atë që u serviret, pa hulumtuar qoftë dhe për pak. Profeti a.s. thoshte: "I shtypuri ka po aq faj sa shtypësi".

Islami është fe në të cilën avancimi në dije është detyrë. Sipas Islamit, njeriu ka potencialin të lartësohet më shumë se engjëjt, se dija apo të diturit e ligjit të ekzistencës është e drejta e çdo qenieje njerëzore. Islami është fe në të cilën "tempull" ke zemrën, ku injoranca është mëkat, ku është detyrë e individit të shpërndajë dijen dhe të ndriçojë mendje. Është kaq e padrejtë të fajësosh këtë Islam për paditurinë e ndjekësve të tij. Një besim fetar, në të cilin është qendëruar e drejta e individit, ku femra dhe mashkulli janë çliruar nga zinxhirët e skllavërisë, nuk duhet të përdoret si propagandë për hir të kësaj apo asaj çështjeje. Nuk është vetëm gruaja myslimane, por femrat në tërësi kanë qenë të sulmuara vazhdimisht, me padrejtësi dhe mizori. Në varësi të shoqërisë ku jeton, femra gjykohet për peshën, për gjatësinë, për nivelin e gabuar të inteligjencës apo edhe për bindjen e gabuar. Gjithsesi, femra duhet pritur krahëhapur në ato vende ku ajo ka dhënë kontributin e saj.

Në kohën që jetojmë, barazia e vërtetë bëhet karakteristikë e utopisë dhe duket pothuajse e pamundur për t'u arritur, por ne, si pjesë të vogla të shoqërisë, a kemi kapacitetin të bashkojmë copëzat dhe të formojmë mozaikë të bukur? Ndoshta disa të tillë do të mund të ishin çelësi për të realizuar atë ëndërr që ka shekuj në pritje.

Ky ishte Muhamedi ﷺ **i thjeshti, modesti**



"Sikur ju të më kërkonit t'ju përshkruaj Muhamedin a.s., nuk do të mundja, sepse sytë e mi asnjëherë nuk u ngopën me dritën e tij."

Amr ibnul As

Profeti Muhamed a.s. ishte mishërimi i lidhjes së vërtetë me Krijuesin e gjithësisë. Ai e kujtonte Atë ditën dhe natën, kur ishte në shtëpi dhe kur ishte në udhëtim. Çdo frymëmarrje e tij ishte përmendje për Zotin. As gjatë gjumit nuk mbeti pa e kujtuar Atë, pasi ndërsa sytë e tij flinin, zemra e tij rrinte zgjuar. Zemra e tij ishte e lidhur me Zotin.

Ky ishte Muhamedi a.s., i thjeshti, modesti

Muhamedi a.s. nuk ishte vetëm një i dërguar si shumë të dërguar të tjerë para tij. Ai ishte profeti, me të cilin Zoti i dha fund zinxhirit të profetëve. Ai ishte një njeri, me të cilin Zoti nderoi dhe gradoi njerëzimin. Nëse drejtësia do të mishërohej dhe merrte formë, ajo do të merrte formën dhe pamjen e Muhamedit a.s. Nëse dëlirësia e shpirtit do të pikasej diku, padyshim do të pikasej në shpirtin e tij. Nëse virtyti do të pikturohej, nuk do të kishte tablo më optimale se ajo e Muhamedit a.s. Po ai ishte njeri, lëvizte në tregje dhe ushqehet si gjithë njerëzit. Ajo që e dallonte nga të tjerët, ishte pikërisht nuri i profecisë, me të cilin rrezatonte. Pishtari i mesazhit hyjnor i ndriçonte udhën atij dhe atyre që i besonin. Fjalët e tij ishin të vërteta, vepra të drejta, udha e sigurt. Mëshira ishte bashkë me të, kudo që të ishte. Bujaria kishte bujtinë shpirtin e tij. Ai i besonte lehtësimit, feja që përçoi ishte e lehtë, Kur'ani që iu shpall ishte i lehtë, tradita e tij ishte e lehtë, urdhrat dhe ndalesat të lehta. Teksa lexon biografinë e kolosëve të njerëzimit përkrah biografisë së Muhamedit a.s., të gjithë të duken të vegjël përballë tij. Kur lexon lajmet e reformatorëve përkrah lajmeve dhe jetës së tij, të gjithë shndërrohen në nxënës të Muhamedit a.s. Nëse mahnitesh me gjenitë, sapo lexon traditën profetike, të gjithë të tjerët i sheh si studentë të universitetit të Muhamedit a.s. Atë e kanë lavdëruar armiqtë përpara miqve dhe i largëti para të afërtit.

"Se ti (o Muhamed) je me virtyte madhore." (Kur'an, Kalem: 4)

Profeti Muhamed a.s. robëroi zemrat e njerëzve me dhembshurinë e vet, bashkoi të përçarët me dashurinë e tij, vëllazëroi fiset me urtësinë e tij, luftoi injorancën me dije dhe kështu me lehtësi hoqi qafe vargonjtë e traditave dhe zakoneve të vjetra. Ai u dërgua me fenë e lehtësimit, me besimin e dëlirë, me natyrën e pastër, me rrugën e mesme. Ai përçoi fenë dhe ndërtoi shtetin, falej si imam dhe predikonte fenë e tij. Secili nga shokët e

tij rrëfen dashurinë për Profetin a.s. sipas mënyrës së vet. Kushdo që ka biseduar me të, përshkruan ndjenjat dhe emocionet të shoqëruara me lot malli. Kushdo që e ka takuar, ka dëshmuar madhështinë e tij, pavarësisht nëse është pajtuar me të apo jo. Askush nuk mban mend ndonjë shkarje të Profetit a.s., askush nuk i ka regjistruar ndonjë gënjeshtër dhe askush nuk njeh ndonjë lapsus apo gabim të tij. Zoti ia ruajti zemrën të dëlirë, ia pastroi shpirtin, ia ruajti shikimin dhe dëgjimin. Vetë Zoti i Lartësuar e zgjodhi të dërguar për mbarë botët, mësues për të paditurit, model dhe shembull për njerëzimin. Sa më shumë lexon mbi jetën dhe biografinë e tij, aq më shumë të shtohet respekti, vlerësimi dhe nderimi për të. Prandaj ai u shndërrua në njeriun më të preferuar dhe më të dashur nga të gjithë. Ai jetoj mes shokëve të tij dhe prej tyre nxori kalifë të drejtë, dijetarë të lidhur me Zotin, interpretues të Kur'anit, predikues oratorë, asketë të devotshëm dhe komandantë legjendarë. Secili nga pasuesit mori një aspekt nga jeta e Profetit a.s., prandaj ata u shndërruan në kolosë të historisë dhe uje të botës.

"Dhe ne të kemi dërguar ty (o Muhamed), si mëshirë për botët." (Enbija, 107)

Shembull ideal dhe mëshirë për gjithë njerëzimin

Në fytyrën e tij gjithmonë shihej një buzëqeshje, në ballin e tij dallohej një dritë, nga zemra e tij buronte dashuria dhe nga dora e tij rridhte bujaria. Me pak fjalë, ai ishte i bekuar në çdo mënyrë të mundshme. Edhe atëherë kur shpata i qëndronte mbi kokë në formë kërcënimi, ai nuk gënjente. Edhe atëherë kur e joshnin me premtime për thesaret e botës, ai prapë nuk i shkeli premtimet e tij, sepse ishte i zgjedhuri i Zotit, i mbrojtur prej Tij. Ai u dërgua si shembulli ideal dhe mëshirë për gjithë njerëzimin, falës për të tjerët, i cili ua fal shkeljet dhe ua fsheh dobësitë, i cili është i përmbajtur ndaj njerëzve injorantë dhe i mëshirshëm ndaj të varfërve e të dobëtëve.

Dinjiteti i tij arrinte ato grada sa frymëzonte tek të tjerët nderim, dashuri dhe admirim.

Ai e jepte ndihmën e tij rregullisht në punët e shtëpisë; ndizte vetë zjarrin, fshinte shtëpinë, milte dhinë, arnonte rrobat dhe qepte këpucët. Në portretin profetik kishte një përputhje të plotë dhe harmoni mes pamjes fizike dhe botës shpirtërore. Ishin pikërisht virtytet shpirtërore të Profetit a.s. që e renditën dhe e bënë atë më të madhin personalitet të njerëzimit. Në kurmin e tij të pastër bashkoheshin në një vitaliteti, bujaria, ndjeshmëria, drejtësia.

Profeti a.s. nuk thoshte fjalë të tepërta, çdo fjalë e tij ishte këshillë e urtësi. Profeti a.s. ishte i butë, i matur dhe modest. Ai ishte gjithmonë

i buzëqeshur. Te njerëzit ai vlerësonte sjelljen, moralin, formimin dhe edukatën e tyre. Të njohurve u bënte vizita dhe u dërgonte dhurata. Profeti a.s. ishte vazhdimisht i mendueshëm. Ai nuk fliste kur nuk ishte e nevojshme. Heshtja e tij ndonjëherë zgjaste. Kur fillonte të fliste, nuk e linte të papërfunduar mendimin. Shumë ide e mendime i shprehte në mënyrë të qartë e koncize. Fjalët i dallonte mirë nga njëra-tjetra. Asnjëherë nuk është zemëruar për çështje vetjake. Nuk hynte në shtëpinë e askujt pa marrë leje. Kur hynte në kuvend apo ambiente publike, nuk lejonte që t'i ngriheshin në këmbë. Në orar ishte shumë i përpiktë. Shpesh shihej i gëzuar, i butë dhe jo i vrazhdë apo i ashpër. Nuk ka qenë zhurmues, as qortues i madh, as lavdëruar i tepruar.

Bukuria e etikës profetike

Ummu Mabel el Huzai, duke ia përshkruar burrit të vet Profetin a.s., thotë: "Pastërti e pashoqe, me fytyrë bujare, të ndritshme dhe të çiltër, me sjellje të mirë. Nuk ka trup të madh e as kokë të madhe. Është i bukur dhe tërheqës, me sy të zinj, me shikim të thellë të rrethuar me qepalla të dendura dhe të gjata, me vetulla të zezë, as të holla, as të trasha, me flokë shumë të zinj. Kur bie në heshtje e shquan qëndrimi fisnik dhe maturia; e kur flet, e frymëzon shkëlqimi dhe eleganca. Njeriu më i bukur dhe më elegant për së largu, por edhe më i bukur dhe më tërheqës prej së afërmi. Me logjikë të pastër (të kulluar) dhe rezonim të këndshëm. Dhuntia e të folurit si varg margaritarësh. I matur. Modest. As trupshkurtër, që të mos vërehet, as trupgjatë që të bjerë shumë në sy. Më i pashmi mes tre vetëve. I fuqishëm. Ka shokë të përzemërt dhe modestë. Kur flet, e dëgjojnë; kur urdhëron, garojnë për të kryer urdhrin. I shërbejnë, e nderojnë dhe janë besnikë. I dashur dhe gjithnjë i mbrojtur. Nuk është i ngrysur dhe as i vrenjtur. I shoqërueshëm, me sjellje të bukur. I kujdesshëm ndaj bashkëbiseduesit."

Morali i Profetit a.s.

Profeti a.s. asnjëherë nuk kishte përdorur fjalë të turpshme. Edhe atëherë kur donte të sqaronte diçka, huazonte fjalë të largëta që njeriu i mençur i kuptonte. Asnjëherë nuk u kishte bërë titur shokëve, shoqëruar apo njerëzve të tjerë, por thjesht mjaftohej duke thënë: "Sikur ta kishte bërë kështu."

Fëmijët e vegjël e merrnin për dore dhe e çonin ku të donin, e ai nuk mërzohej. Kur takonte dikë, e shihte në sy dhe e shoqëronte me shikim, sa që atij i dukej se është njeriu më i dashur në zemrën e Profetit a.s.

Nuk e hiqte dorën pa e hequr tjetri dhe nuk e shmangte shikimin pa e larguar tjetri. Gjithmonë në kuvendin e tij kishte vend për të gjithë dhe kur

dikush nuk kishte ku të ulej, Profeti a.s. i zgjaste rrobën e tij. Nuk i kishte shtrirë asnjëherë këmbët para shokëve të tij. Ishte i butë, ftonte për butësi dhe thoshte se Zoti e shpërblen butësinë më shumë se çdo gjë tjetër. Ishte njeriu që buzëqeshte më shumë se të gjithë. Ishte bujar i rrallë dhe këtë e bënte pa u sforcuar, duke thënë se ishte urdhëruar për bujari.

Ishte fytyrë ëmbël, natyrë e butë, as i rëndë në kritikë e as i tepruar në të lavdëruar. I pëlqente t'i thërriste njerëzit me emrat që atyre u pëlqenin, nuk ua priste fjalën derisa të mbaronin. Kur i erdhi për vizitë delegacioni i Abisinisë, u ngrit në këmbë duke iu shërbyer me dorën e tij, duke thënë se këta na i respektuan shokët. Me një modesti të admirueshme i bënte njerëzit të ndiheshin më mirë pranë tij, duke u thënë se ishte i biri i një gruaje të varfër.

Kur po çlironte Mekën, koka e tij prekte shpinën e devesë nga modestia. Kush e shihte nga larg, e admironte; kush e takonte, e donte dhe kush kishte qenë shoqëruar i tij, e kishte të vështirë pa të të jetonte. Ky është Pejgamberi a.s. që u kishte shkruar letra mbretërve persë e romakë, e nga ana tjetër, me dëshirën më të madhe, i veshur me rrobën e tij të thjeshtë, ulej në dyshtet e shtëpisë që fëmijët të kënaqeshin të hipur mbi shpinën e tij. Ky është njeriu të cilin Zoti e solli shembull dhe model për besimtarët.

Muhamedi a.s. për diturinë

Fjalët e Profetit a.s. i dhanë një impuls të ri zgjimit të energjive që kishin qenë të fjetura. Gjatë jetës së tij u formua bërthama e një instituti edukativ që më vonë u dha jetë shumë universiteteve në Bagdad, Salerno, Kajro dhe Kordovë. Ja çfarë predikonte ai për kultivimin e virtuteve më të larta shpirtërore:

"Një orë meditimi mbi veprën e Krijuesit është më i vlefshëm se shtatëdhjetë vite lutje."

"Të dëgjosh mbi shkencën dhe të mësosh për një orë është më e vlefshme se të falësh xhenazet e një mijë martirëve..."


"Atij që vihet në kërkim të dijes, Zoti do t'i garantojë një vend të lartë në kuvendet e bekuara të Xhenetit. Çdo hap i tij është i bekuar dhe për çdo mësim që përvetëson shpërblehet."

"Ai që kërkon dijen do të përshëndetet për zëmërsisht nga engjëjt e Xhenetit."

"Të dëgjosh fjalët e të diturit dhe të rrënjësosh në zemër mësimet e shkencës është më mirë se të lirosh njëqind robër."

"Ai që nderon dijen dhe të diturin do nderohet nga Zoti në botën tjetër. Ai që ka respektuar dijetarin më ka respektuar mua."

Si e shfrytëzonte kohën Profeti a.s. dhe si e organizonte atë?



Profeti a.s. e ndante kohën në tre pjesë: njërën ia kushtonte Allahut, tjetrën familjes, ndërsa pjesën e tretë e ndante për veten dhe bashkëkohësit e tij. Ai nuk përtonte t'u ofronte njerëzve këshilla dhe udhëzime. Atë pjesë të kohës që i përkushtonte umetit ai e kalonte duke u shërbyer nevojave të njerëzve, në varësi të statusit të tyre. Ai qëndronte pranë njerëzve duke u mësuar çfarë është e dobishme për ta dhe duke i informuar sipas nevojave.

Profeti i Allahut ishte i mëshirshëm, i dhembshur, i ndrojtur dhe modest. Ai ishte aq i thjeshtë sa nëse ndonjë i huaj hynte në xhaminë e tij dhe shikonte një grup njerëzish brenda saj, nuk ishte në gjendje ta dallonte nga shokët e tij.

Profeti a.s. kryente vetëm ato vepra përmes të cilave arrinte kënaqësinë e Allahut. Ai u lëndua dhe u dhunua gjatë thirrjes së popullit të tij në Islam, megjithatë, u tregua i duruar dhe rezistoi ndaj çdo vështirësie, duke shpresuar në shpërblimin e Allahut, të Madhërishmit.

Abdullah ibn Mesudi tregon: "Ai ishte një Profet që u lëndua nga njerëzit e tij, e megjithatë ai fshihi gjakun nga fytyra dhe tha: "O Allah, fali sepse nuk e dinë të vërtetën!"

Muhamedi a.s., mbrojtës i mjedisit

Një lexim i kujdesshëm i haditheve, thënieve që përshkruajnë ngjarje të rëndësishme në jetën e Profetit a.s., dëshmon se ai ishte një avokat i vendosur i mbrojtjes mjedisore. Ai ishte "ambientalist me vepra", një udhëçelës në domenin e ruajtjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të burimeve, një individ që u përpoq vazhdimisht të ruante një balancë harmonike mes njeriut dhe natyrës. Profeti a.s. tregonte kujdes të veçantë për faunën dhe florën, si dhe ruante një lidhje thuajse intime me katër elementet, tokën, ujin, zjarrin dhe ajrin.

Ai ishte mbrojtës i fortë i përdorimit të kursyer të ujit dhe kultivimit të kujdesshëm të tokës, trajtimit të mirë të kafshëve, bimëve, zogjve dhe të drejtave të barabarta të shfrytëzuesve të këtyre të mirave. Në këtë kontekst, konceptet që ai u paraqiti pasuesve të tij janë veçanërisht mbresëlënëse, pasi filozofia ambientaliste e tij bazohet tek e shenja.

Të tjerët për Profetin e Islamit

"Ah, te ky djalosh zemërmadh me sy të zinj rrëzëllitës dhe shpirt të butë e pranues ndaj çdo elementi të një shoqërie që gjallonte mes egërsisë, kishte vend për të tjera mendime, përtej ambicies.

Një njeri madhështor që fliste me heshtje. Ai ishte një nga ata njerëz që nuk mund të sillej ndryshe, vetë Zoti e kishte përzgjedhur të ishte i singertë. Ndërsa të tjerët gjallonin mes të rëndomtës dhe thashethemeve, të kënaqur me mjedisin në të cilin jetonin, ky njeri nuk e shikonte veten pjesë të të njëjtit mjedis. Ai ishte i vetmuar me shpirtin e tij dhe realitetin e dukurive që e rrethonin. Misteri i madh i qenies, siç e përmenda edhe më parë, vetëtiu mbi të me frikët dhe shkëlqimin e tij; asnjë fjalë nuk mund ta fshihte faktin e pamohueshëm. – Këtu jam unë!" – ky sineritet, siç ne e quajmë, përmban vërtet diçka hyjnore. Vepra e një njeriu të tillë është thirrje e drejtpërdrejtë nga zemra e natyrës. Njerëzit e dëgjojnë atë dhe duhet ta dëgjojnë si asgjë tjetër; gjithçka ndryshe është dredhi e padobishme."

Thomas Carlyle në librin e tij "Mbi heronjtë dhe heroiken në histori"

"Sigurisht që ai trupëzonte dy karakteristikat më të rëndësishme të rendit profetik. Ai pa të vërtetën mbi Zotin, çka bashkëkohësit e tij nuk mund ta shikonin, dhe kishte një prirje të parëzistueshme dhe impulsive për ta proklamuar këtë të vërtetë."

Dr. Marcus Dods në veprën e tij "Muhamedi, Buda dhe Krishti"

Si reagonte Profeti a.s. ndaj kritikave?

Kritika pranohet me vështirësi edhe nga njeriu më modest, veçanërisht kur bëhet pa takt dhe padrejtësisht. Ashtu si thika, kritika shpeshherë shkakton plagë të thella dhe ndan edhe miqtë më të mirë.

Megjithatë, Profeti Muhamed a.s. ishte shembullor jo vetëm në aftësinë për t'i pranuar kritikën me përulësi, por edhe për t'i përdorur ato për arritjen e rezultateve pozitive.

Njëherë Omeri r.a. kritikoi ashpër dikë që iu drejtua pa takt Profetit a.s., duke i kërkuar një borxh që i kishte dhënë. Profeti a.s. po shihte i buzëqeshur nga Omeri dhe i tha: "O Omer, në vend të kësaj duhet të na jepje ndonjë këshillë të singertë! Më mirë do të ishte të kërkoje prej meje t'ia kthej borxhin atij kurse prej tij ta kërkojë hakun e vet më mirë dhe më butë."

Mëshira pas fitores

Është e thjeshtë të tregohesh i mëshirshëm dhe falës kur gjendesh në pozita të dobëta. Por kur zotëron pushtet dhe të krijohet mundësia, njerëzit priren të abuzojnë me autoritetin dhe t'i ndëshkojnë rëndë kundërshtarët.

Edhe në këtë aspekt sjellja e Profetit Muhamed

a.s. ishte unike. Shembulli më i mirënjohur është çlirimi paqësor i Mekës nga myslimanët. Në çastin kur mund t'i kishte shkatërruar me lehtësi armiqtë e tij, Muhamedi a.s. tregoi vetëpërmbytje mbresëlënëse.

Mes atyre që Profeti a.s. fali ishte edhe Ebu Sufjani, një nga prijësit e kundërshtarëve të Islamit; Ikrima ibn Ebu Xhehli, djali i njërit nga armiqtë e betuar të Profetit a.s.; Hindi, gruaja e Ebu Sufjanit, që dhunoi kufomën e xhaxhait të Profetit a.s., Hamzait; Uahshi, njeriu që u pagua nga Hindi për të vrarë Hamzain, etj. Asnjëri nga këta persona nuk u ndëshkua për krimet e tij. Profeti a.s. u sigurua që askush të mos hakmerrej.

Ishte një 'revolucion' paqësor i ngjyrosur nga mëshira për armikun. Shumë myslimanë i kanë harruar këto mësimë. Krahasojini këto qëndrime me ato të disa myslimanëve që i mallkojnë të tjerët të shkojnë në ferr dhe lutën për shkatërrimin e tyre. Askush prej nesh nuk e di ku do të përfundojë në botën e përtejme. Prandaj, të vazhdojmë të lutemi që të mbetemi në rrugë të drejtë dhe që edhe të tjerët të udhëzohen.

Buzëqeshja e fundit

Enes ibn Maliku tregon: "Ebu Bekri priu namazin e një xhenazeje gjatë kohës që Profeti a.s. u sëmur. Të hënën, ndërsa besimtarët u rreshtuan për të falur, Profeti a.s. hapi perden e dhomës së tij dhe pa nga ata që po faleshin. Pavarësisht dobësisë së tij ai u buzëqeshi të pranishmëve. Enesi tregon se ata u gëzuan dhe u befasuan nga vështrimi që Profeti a.s. u hodhi ndërsa bëheshin gati për falje. Ebu Bekri bëri një hap pas, duke menduar se Profeti a.s. do të vinte të drejtonte faljen, por ai u bëri me shenjë që të vazhdonin. Pastaj me një shprehje kënaqësie në fytyrë ai uli perden dhe shkoi në dhomën e Aishes. Në po të njëjtën ditë ai u largua nga kjo botë. Ai u nda nga shokët e tij me një buzëqeshje. Buzëqeshja e Profetit a.s., si për xhematin e asaj kohe, por edhe për kohën tonë, është një kujtim i vyer, një përgjegjësi e pafund. Domethënien e thellë të saj mund ta përjetojmë vetëm nëse reflektojmë dhe veprojmë në përputhje me atë që e kënaqte Profetin a.s.. Ne duhet të jemi xhemati, komuniteti që e kënaq Profetin a.s. Çdo mysliman duhet ta gdhendte këtë kujtim në zemrën e tij dhe ta përkujtojë në fshehtësi.

Profeti a.s. pushtoi shumë zemra me buzëqeshjen e tij të ëmbël, me temperamentin bujar dhe durimin e tij. Zoti i drejtohet Profetit a.s.

me këto fjalë: "Po të ishe treguar i ashpër dhe i pandjeshëm, ata me siguri do të ishin larguar prej teje." (Al Imran, 159)

Do të jenë me të në Parajsë

Theubani r.a. e deshi jashtë mase Profetin a.s. dhe nuk mund ta duronte ndarjen prej tij. Një ditë kur iu afrua, fytyrën e kishte shumë të zbehtë dhe dukej shumë i trishtuar. Profeti a.s. e pyeti se si qëndronte puna dhe ai iu përgjigj: "O i dërguari i Allahut, unë nuk kam dhimbje dhe nuk jam i sëmurë, por sa herë që jam larg teje, ndihem tepër i mjeruar derisa arrij të të shoh. Për më tepër, kur kujtoj botën tjetër, unë frikësohem për shkak se ju do të ngjiteni në "Iljin" pallate madhështore me profetët. Nëse unë hyj në parajsë, do të jem në një nivel më të ulët se ju. Gjithashtu, nëse nuk hyj në parajsë, nuk do të kem kurrë mundësinë të të shoh." Më pas u shpall ajeti vijues.

"Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!" (Nisa, 69)

Ai është Profeti i të gjithëve

"O njerëz! Zoti juaj është një. Keni një origjinë. Të gjithë jeni bijtë e Ademit a.s. e Ademi është prej balte. Arabi nuk ka epërsi mbi jo-arabin, sikurse jo-arabi mbi arabin; as i bardhi mbi të ziun e as i ziu mbi të bardhin. Vlera e lartë është vetëm në takva (devotshmëri), t'i frikësohesh Allahut."

Kjo ishte thirrja e Profetit të Islamit a.s. teksa largohej nga kjo botë. Vetëm për umetin u mundua, e para se të nisej pyet: "A e kreve detyrën?", ku si përgjigje i kthehet një jehonë e thellë e përbotur nga sahabët (shokët): "Po, ja Resulallah!" Pas kësaj, me një qetësi të begatë thotë: "Dëshmo, o Allahu im!", drejtuar pafundësive.

Ai ishte Profeti i të gjithëve. Ishte përherë në përpjekje për shpëtimin e bijve të Ademit. Po edhe umeti nuk e harroi kurrë. Sa herë që kujtohet ai, zemra e besimtarit dridhet ëmbël me ngazëllim prej butësisë së begatë të qenies së tij.

Muhamedi a.s. nuk ishte udhëheqës vetëm për një grup njerëzish, të cilët ishin të mirë për shkak se ai ishte i mirë, dhe që kur vdiq u venitën. Ai ishte një forcë mirësie, që luajti një rol të rëndësishëm në botën morale, të ngjashëm me rolin që luajti zbulimi i avullit dhe elektricitetit në botën materiale.

NDIKIMI I ISLAMIT NË MJEKËSINË BOTËRORE (2)



Mjekësia islame: 1000 vjet më parë¹
Pjesa dytë

Anestezia: Ibn Sina është i pari që futi idenë e përdorimit të anestetikëve nga goja. Ai njihte opiumin si anestetikun (mukhadirin) më të fuqishëm. Anestetikët më pak të fuqishëm ishin mandërgona, lulëkuqja, kuskuta (flokështiga), idhnakthi (beladoni), farat e marules dhe bora ose uji i akulluar. Arabët kanë shpikur sfungjerin gjumësjiellës (soporifik) - pararendësi i anestesisë me modern. Ai ishte një sfungjer i njomur me aromatikë dhe narkotikë, që vihej në vrimat e hundës së pacientit. Përdorimi i anestesisë ishte njëri nga faktorët që kirurgjia në botën islame u ngrit deri në nivelin e një specialiteti të nderuar, kur në Europë, kirurgjia nënvlehtësohej dhe ushtrohej nga berberë dhe sharlatanë. Më 1163 të erës sonë, Council of Tours deklaronte që kirurgjia të braktisej nga shkollat e mjekësisë dhe nga mjekët e ndershëm. Burtoni ka thënë: "Anestetikët janë përdorur në kirurgji për shekuj të tërë në të gjithë Lindjen përpara se në Perëndimin e qytetëruar të bëhej modë eteri dhe kloroformi".

Kirurgjia: Al - Raziu konsiderohet si i pari që ka përdorur në kirurgji drenin dhe stomakun e kafshëve për qepje. Ebu al Kasim, Khalaf ibn Abbas al Zahraui (930 - 1013, era jonë), i njohur në Perëndim si Abulkasis, konsiderohet si kirurgu më me emër në mjekësinë islame. Në librin e tij, "Al - Tasrif", ai përshkroi hemofilinë për të parën herë në historinë e mjekësisë. Libri përshkruan dhe ilustron rreth 200 instrumente kirurgjikale, shumë nga të cilat u shpikën nga vetë Zahraui. Zahraui theksonte në libër rëndësinë e studimit të anatomisë, si një domosdoshmëri themelore për kirurgjinë. Ai mbështeti rimbjelljen e dhëmbit të rënë dhe përdorimin e protezës dentare të gdhendur nga kocka e lopës, që konsiderohet më e mirë se proteza prej druri, të cilën e pati mbajtur presidenti i parë i Amerikës, Xhorxh Uashington

1. Botohet me shkurtime. (redaksia)

shtatë shekuj më vonë. Zahraui është kirurgu i parë në histori që ka përdorur pambukun (në gjuhën angleze pambuk është cotton- fjalë me prejardhje arabe) në mjekimet kirurgjikale, për të ndaluar hemorragjinë, si mbushje në gështalla, si mbushje vaginale në frakturat e kockave të pelvisit dhe në kirurgjinë e dhëmbëve. Ai futi metodën e heqjes së gurëve në veshka, duke i copëtuar në fshikëzën e urinës. Ai qe i pari që u mësoi të tjerëve pozicionin lithotomik (lithotomi= hapje kirurgjikale e fshikëzës së urinës për heqjen e gurëve që ndodhen në të) për operacionet vaginale. Ai përshkroi trakeotominë (operacion i hapjes së skërfyellit), dalloi strumën nga kanceri i gjendrës tiroide dhe shpjegoi shpikjen e tij të djegies (kauterizimit) me hekur, të cilën e përdori për të ndaluar edhe gjakrrjedhjen. Përshkrimi i tij për lirim të varicëve (venave varikoze) është thuajse edhe sot i tillë në kirurgjinë moderne. Në kirurgjinë ortopedike, ai futi atë që sot quhet metoda e Koçerit për uljen e zhvendosjes së kockës së supit dhe prerjen e kockës së kupës së gjurit (patellatomi), 1000 vjet përpara se Bruk ta rifuste atë më 1937. Përshkrimi i Ibn Sinës për trajtimin kirurgjikal të kancerit është i vlefshëm edhe sot pas 1000 vjetësh. Ai thotë se prerja duhet të jetë e gjerë dhe e guximshme; të gjitha venat që shkojnë tek tumori, duhet të përfshihen në prerje; në qoftë se kjo nuk është e mjaftueshme, atëherë zona e prekur duhet të digjet (kauterizohet).

Mjekët islamë praktikonin tri tipe kirurgjie: vaskulare (e enëve të gjakut), e përgjithshme dhe ortopedike. Ata e hapnin me lehtësi barkun (abdomenin) dhe drenonin zgavrën peritoneale (zgavrën e mesit), ashtu si edhe sot. Një kirurgu të panjohur të Shirazit i atribuohet operacioni i kolostomisë (krijim me operacion i një fistule të zorrës së trashë në sipërfaqen e trupit). Absceset e mëlçisë trajtoheshin me funksion (shpim) dhe me eksplorim.

Sot, në të gjithë botën, mjekët zbatojnë disa procedura kirurgjikale që i pati futur në kirurgji Zahraui 1000 vjet më parë.

Trajtimi i sëmundjeve të syve: Mjekët islamë kanë treguar aftësi të shquara në trajtimin e sëmundjeve të syve dhe kanë qenë të parët në këtë fushë. Fjalë të tilla, si retinë dhe katarakt janë me prejardhje nga arabishtja. Ibn - al Hajthem (965 - 1039, era jonë), i njohur në Perëndim si Alhazen shkroi "Optical Thesaurus", nga i cili morën teoritë për shkrimet e tyre të tillë dinjitarë, si Roxher Bejkën, Leonardo da Vinçi dhe Johanes Kepler. Në "Thesaurus-in" e tij ai tregoi se drita bie në retinë në të njëjtën mënyrë, siç bie në një sipërfaqe në një dhomë të errët nëpërmjet një hapjeje të vogël. Kështu, ai provoi se pamja vjen kur rrezet e dritës kalojnë nga objekti te syri dhe jo nga syri tek objekti, siç mendohej nga grekët. Ai paraqiti eksperimente për të provuar këndin e rënies dhe këndin e pasqyrit dhe një propozim teorik për lentet zmadhuese (që u realizuan në Itali tre shekuj më vonë). Ai na mësoi, gjithashtu, se imazhi në retinë përcillet në tru nëpërmjet nervit optik.

Raziu që i pari që njohu reagimin e bebes së syrit ndaj dritës, kurse Ibn Sina që i pari që përshkroi numrin e saktë të muskujve të jashtëm të kokërdhokut të syrit, domethënë gjashtë. Kontributi më i madh i mjekësisë islame në oftalmologjinë praktike që për kataraktin (perden e syrit). Arritja më e rëndësishme në heqjen e perdes së syrit erdhi nga Ammar bin Aliu i Mosulit, i cili e bënte këtë nëpërmjet një gjilpërë të zgavërt metalike përmes cipës së bardheme (sklerës) dhe nxirrte lentet me thithje. Europa e ka rizbuluar këtë në shekullin XIX.

Mjekimi i sëmundjeve pa ndërhyrje kirurgjikale: Për këtë mund të thuhet shumë e shumë. Por, për arsye vendi, do të përmendim vetëm disa çështje. Kontributi më i madh u dha nga Raziu, i cili bëri dallimin midis lisë dhe fruthit - dy sëmundje që deri atëherë konsideroheshin si një sëmundje. Në urologji, ai u përqendrua te problemet e urinimit, te sëmundjet veneriane (sëmundje që përhapen nga marrëdhëniet seksuale), infeksionet e veshkave, gurët në veshka dhe fshikëzën urinare. Ai përshkroi alergjinë nga lulet. Arabët zbuluan parazitin e zgjebes (nga Ibn Zuhr), bakterin e plasjes (antraksi), parazitin e ankilostomës dhe parazitin e Guinesë (nga Ibn Sina) dhe sëmundjen e gjumit (që shkaktohet nga pickimi i mizës cece) (nga Kalkashandi). Ata përshkruan abscesin e mesmuores (mediastinit). Ata kuptuan turbekulozin dhe pezmatimin e perikardit (pjesa membranore që rrethon zemrën). Al Hash'ath demonstroi fiziologjinë gastrike 1000 vjet përpara Biemontit. Ebu Shal al-Masihi shpjegoi se përthithja e ushqimit ndodh më shumë nëpërmjet zorrëve sesa nëpërmjet stomakut. Ibn Zuhr futi të ushqyerin artificial me tubin gastrik, ose me klizmën ushqyese. Duke futur tubin në stomak, mjekët arabë bënë lavazhin gastrik (të stomakut) në rast helmimi. Ibn al Nafis që i pari që zbuloi qarkullimin mushkërior.

Në kryeveprën e tij, "Al - Kuanun", Ibn Sina bëri studime të plota për fiziologjinë, patologjinë dhe

higjienën. Ai ka shkruar në mënyrë të veçantë për kancerin e gjirit, helmimet, sëmundjet e lëkurës, tërbimin, pagjumësinë, lindjen e fëmijës dhe përdorimin e pincave obstetrike, meningjitin, humbjen e kujtesës (amnezinë), ulçerat e stomakut, tuberkulozin, prerjen e venës, tumoret, sëmundjet e veshkave etj.

Farmakologjia: Metodat e përfutimit dhe të përgatitjes së barnave arritën në një shkallë të lartë dhe teknikat e distilimit, kristalizimit, tretjes, kthimit të një substance nga e ngurtë në të avullt, reduktimit dhe kalcifikimit u bënë procese thelbësore të farmacisë dhe të kimisë. Me ndihmën e këtyre teknikave farmacistët futën barna të reja, të tilla si kamfori, sena, sandali, raveni, myshku, mirra, tamarindi (hurmë indiane), arra e hindit, sulfati i aluminit dhe i kaliumit, aloeja, karafil, arra e kokosit, akonita, mërkuri etj. Roli i rëndësishëm i myslimanëve në zhvillimin e farmacisë dhe të kimisë së sotme përkujtohet me numrin e madh të termave të sotëm farmaceutikë dhe kimikë që vijnë nga gjuha arabe: alkaline, alkool, aldehide, elikzir etj., për të mos përmendur shurupet etj. Ata shpikën ekstrakte aromatizuese nga uji i trëndafilut, uji i luleve të portokallit, lëkurat e portokallit dhe të limonit etj. dhe përbërës të tjerë të këndshëm.

Psikoterapia: Në fushën e çrregullimeve psikosomatike, edhe Raziu, edhe Ibn Sina arritën rezultate shumë të mëdha, duke i paraprirë Frojdit dhe Jungut me 1000 vjet. Kur Raziu u emërua kryemjek në spitalin e Bagdadit, e bëri atë spitalin e parë që kishte një pavijon vetëm për të sëmurë mendorë.

Arabët nuk i kishin teoritë demonologjike që kishin përfshirë botën e krishterë dhe për këtë arsye, ata ishin të aftë të bënin vrojtime të qarta klinike për të sëmurë mendorë.

exhep ud din Muhammed, bashkëkohës i Raziut, ka lënë shumë përshkrime të shkëlqyera për sëmundje të ndryshme mendorë. Ai ka përshkruar depresionin, llojet e neurozave obsesive, impotencën seksuale, psikozën persekutuese, dua - kulb-in (një formë manie) etj.

Ibn Sina njihnte psikologjinë fiziologjike për trajtimin e sëmundjeve që kanë të bëjnë me emocionet. Nga pikëpamja klinike, Ibn Sina krijoi sistemin e ndryshimeve shoqëruese (asociative) të rrahja e pulsit me ndjenjat e brendshme, çka është parë si paraprirëse e shprehjes "testi asociativ" i Jungut. Thuhet se ai ka mjekuar një të sëmurë rëndë, duke i ndier pulsën dhe duke i përmendur me zë të lartë emrat e provincave, rajoneve, qyteteve, rrugëve dhe njerëzve. Duke parë se si shpejtohej pulsi i pacientit kur përmendeshin emrat, Ibn Sina arriti në përfundimin se i sëmuri kishte rënë në dashuri me një vajzë, vendbanimin e së cilës ai kishte mundur ta lokalizonte me anë të ekzaminimit dixhital. I sëmuri mori këshillën e Ibn Sinës, u martua me vajzën dhe u shërua.

Nuk ka përse të habitemi për të mësuar se në Fes, Marok ishte ngritur një azil për të sëmurë mendorë që në fillim të shekullit VIII; azile për të sëmurë mendorë qenë ndërtuar nga arabët edhe në Bagdad (në vitin 705, era jonë), në Kajro (në vitin në vitin 800), në Damask dhe Halep (në vitin 1270). Përveç banjave për t'u larë, barnave, trajtimit mirëdashës dhe të përzemërt, përdoreshin edhe terapia muzikore dhe terapia profesionale. Këto terapi u zhvilluan shumë. Kore dhe banda muzikore sillleshin çdo ditë për t'i dëfryer të sëmurë me këngë, shfaqje muzikore dhe shfaqje komike.

Rreth nesh, jo mbi ne

**NJERËZORJA E HARRUAR DHE PSE
HESHTJA KRITIKE ËSHTË MËSHIRË**



Në kohën e zhurmës së rrjeteve sociale, të fjalimeve të shkurtra dhe të përgjigjeve të gatshme, shumë njerëz gjejnë ngushëllim te zërat që tingëllojnë të sigurt dhe bindës. Një fjali e thjeshtuar, një koment i prerë, një përgjigje e menjëhershme krijojnë ndjesinë se më në fund dikush ka thënë atë që ne ndjejmë. Kështu figura të ndryshme, fetare apo laike, ngrihen në një lloj piedestali që shpesh nuk e kanë kërkuar vetë, por që u vendoset mbi supe nga publiku. Ky shkrim nuk flet për individë të veçantë, por për një dukuri që po bëhet gjithnjë e më e pranishme: idealizimin e zërave publikë dhe humbjen e njerëzores si te ata, ashtu edhe te ne.

Shumë prej nesh, pa e kuptuar, kërkojnë dikë që flet me siguri në një botë të pasigurt. Ambiguiteti dhe dyshimi janë të vështira për t'u duruar, prandaj çdo zë që ofron qartësi të menjëhershme bëhet tërheqës. Psikologjikisht ne kërkojmë stabilitet; sociologjikisht kërkojmë autoritet; shpirtërisht kërkojmë orientim. Por kur kjo nevojë kthehet në varësi dhe dikush fillon të shihet si i pagabueshëm, atëherë kemi kaluar kufirin e shëndetshëm. Marrëdhënia mes publikut dhe figurave publike fillon të përshkallëzohet në një model të rrezikshëm për të dyja palët.

Në këtë kontekst, rrjetet sociale e thellojnë më tej problemin, duke i kthyer çështjet më të ndërlikuara të fesë dhe etikës në përmbajtje të konsumueshme. Fjalimet shndërrohen në formula: "tre rregulla të arta", "dy hapa drejt lumturisë", "sekreti i suksesit", "përgjigjja e vetme e saktë". Ndjekësit i besojnë këto receta, sepse ato u përgjigjen nevojave emocionale shumë më shpejt se çdo proces i thelluar studimi. Por feja nuk është listë këshillash të thjeshtuara. Etika nuk është tabelë udhëzimesh të gatshme. Dija nuk është një shportë e paketuar bukur për t'u konsumuar.

Pikërisht këtu lind varësia. Audienca fillon të heqë dorë nga pjekuria e vet morale dhe intelektuale. Pyetjet shtohen: "A është hallall kjo?", "A e kam të lejuar këtë?", "Çfarë duhet të bëj në këtë rast?", sikur vendimet e jetës të mund të delegohen tërësisht te dikush tjetër. Tradita islame ka qenë gjithmonë e ndërtuar mbi kërkimin, qasjen kritike, krahasimin e mendimeve, peshimin e argumenteve dhe pranimin e pluralitetit brenda horizontit të së njëjtës fe. Mjafton të kujtojmë se tradita juridike islame ka funksionuar për shekuj me shkollë të ndryshme mendimi, ku pajtimi me një mendim nuk kërkonte mohimin e tjetrit.

Në këtë situatë të idealizimit dhe varësisë nga përgjigjet e gatshme, pyetja që duhet të shtrojmë është e thjeshtë: a e pranojmë se një çështje mund

të ketë disa qasje të vlefshme? A kemi guximin të kërkojmë një mendim të dytë? A kemi pjekurinë të qëndrojmë me faktin që ka çështje ku dijetarët e intelektualët kanë menduar ndryshe, edhe kur kjo na ngushton rehatinë? Mendimi islam e ka njohur historikisht këtë shumësi mendimesh; dijetarë të brezave të ndryshëm kanë menduar ndryshe për shumë çështje, shpesh duke bashkëjetuar me respekt dhe duke e pranuar ndryshimin si pjesë të mëshirës hyjnore. Toleranca ndaj ambiguitetit nuk është dobësi, por një pjekuri shpirtërore që na mbron nga tendenca për ta ngarkuar njeriun me peshën e absolutit. Pikërisht këtu fillon edhe rreziku i idealizimit.

Sepse sapo të humbasim këtë aftësi për të duruar mendimet e ndryshme, ne nisemi t'i ngarkojmë dikujt peshën e absolutit. Idealizimi nuk dëmton vetëm publikun; ai është padrejtësi e madhe ndaj atyre që ngrihen në një vend që nuk u takon. Kur dikush shihet si i përkryer, si njeri që nuk guxon të gabojë apo të ndryshojë, ai ngarkohet me një barrë që askush nuk mund ta mbajë. Askush nuk është krijuar të jetë i pandryshueshëm. Idealizimi e mohon këtë të vërtetë njerëzore dhe i heq njeriut të drejtën për të kaluar sprovë, për të rishikuar veten, për t'u shëruar dhe për të rifilluar. Kjo nuk është shenjë dashurie, por trysni që e dëmton si njeriun që idealizohet, ashtu edhe bashkësinë që e vështrohet me sytë e absolutit.

Në këtë marrëdhënie të ndërlikuar mes publikut dhe figurave publike, përgjegjësia është e ndarë. Publiku ka detyrimin të mos ndërtojë idhuj nga mishi, të mos kërkojë absolutizëm nga një njeri i vetëm, të mësojë të pyesë dhe të kërkojë dije nga burime të ndryshme. Ndërsa figurat publike duhet të kultivojnë vetëdijen për ndikimin që kanë, të kujdesen të mos krijojnë varësi, të nxisin pavarësinë morale të publikut dhe të mos pretendojnë ekskluzivitet mbi të vërtetën. Qëllimet i di vetëm Allahu, por përgjegjësia e sjelljes është e dukshme për të gjithë.

Në fund, bota jonë nuk ka nevojë për figura të idealizuara, por për njerëz të sinqertë. Ka nevojë për publik të pjekur që kërkon dije, jo idhuj; që kërkon kuptim, jo formula të shpejta; që e pranon se jeta, përfshirë aspekti fetar e shpirtëror, është udhëtim, jo pozicionim i pandryshueshëm. Le të mos shndërrojmë fenë në konsum, as njerëzit në simbole të ngrira. Le të mësojmë të jetojmë me pyetje, me kërkim dhe me pluralitet, duke pranuar se vetëm Allahu është absolut. Maturia fetare fillon pikërisht aty: mes përlusësive njerëzore dhe kërkimit të sinqertë të së vërtetës.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe Uzbekistan

(Sfidat e kohëve moderne)



Trashëgimia kulturore dhe historike e një vendi dhe e një populli është ajo që e bën një grup njerëzish krenarë për atë që ata kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre, duke i bërë të njohur edhe për pjesën tjetër të botës.

Trashëgimia e ruajtur, qoftë e prekshme apo e paprekshme, është pikërisht ajo që krijon identitetin dhe qytetërimin e një vendi dhe popullit të atij vendi, duke mundësuar përfaqësimin e tij në mënyrën më të drejtë, në nivel kombëtar dhe botëror.

Trashëgimia kulturore dhe historike e një vendi mund të ndahet në disa grupe:

- Mund të jetë në aspektin kulturor, që përfshin gjuhën, letërsinë, veshjen, ushqimin, zakonet dhe traditat e jetës së përditshme të një populli a kombi;
- Mund të jetë arti, muzika dhe arkitektura e atij vendi;
- Mund të jetë feja dhe trashëgimia kulturore-fetare e një vendi dhe popullit të tij;
- Dhe mund të jetë mjekësia, shkenca dhe teknologjia e atij vendi dhe popullit të tij.

Me pak fjalë, çdo gjë që është unike për një vend, duke e bërë atë të ndryshëm nga fqinjët e tij, rajoni dhe pjesa tjetër e botës, bën të mundur krijimin e identitetit të atij vendi, i cili është i nevojshëm që të ruhet me fanatizëm dhe duhet kultivuar dhe zhvilluar gjatë çdo brezi të ri.

Në këtë drejtim, ashtu si shqiptarët, edhe uzbekët, pavarësisht ngjarjeve të ndodhura në periudha të ndryshme historike për të dy vendet dhe popujt, kanë ruajtur një trashëgimi të pasur kulturore të pakrahasueshme me vendet tona fqinje, më gjerë në rajon apo me pjesën tjetër të botës.

Ashtu si shqiptarët në rajonin e Ballkanit dhe Evropës janë shumë të ndryshëm nga njerëzit dhe vendet përreth nesh, uzbekët janë të ndryshëm nga popujt fqinjë të tyre në Azinë Qendrore për sa i përket kulturës dhe trashëgimisë së tyre.

Për shkak të globalizimit të sotëm perëndimor, ne mund të kemi zakone apo interesa kulturore të përbashkëta me të tjerët, të cilat në njëfarë mënyre na kanë detyruar të imitojmë njëri-tjetrin duke u larguar nga trashëgimitë tona të ndryshme kulturore, por sërish them, thelbi ynë kulturor është i ndryshëm nga të tjerët.

Epoka të ndryshme sjellin edhe risi të ndryshme në paraqitjen e identitetit kulturor të një vendi, por ne duhet të përpiqemi të kultivojmë dhe të ruajmë me aq sa mundemi trashëgimitë tona unike dhe historike, të cilat kanë ekzistuar ndër njerëzit tanë shumë shekuj para nesh, duke evoluar me kalimin e kohës. Këtu e kam fjalën si për popullin shqiptar ashtu edhe për atë uzbek.

Nëse vazhdojmë të theksojmë ngjashmëritë me të tjerët në kurriz të shkatërrimit të trashëgimisë sonë kulturore dhe historike të ndërtuar nga paraardhësit tanë, atëherë ne jemi bashkëfajtorë në shkatërrimin e identitetit tonë duke mundësuar kështu shkatërrimin tonë si popull dhe si komb.

Unë e di mirë këtë gjë, pasi kështu i ka ndodhur popullit tim, i cili ka pësuar një persekutim kulturor përgjatë historisë. Në veçanti mund të përmend shkatërrimin e pamëshirshëm të një kulture të caktuar të popullit tim dhe të vendit tim nga komunistët, qëllimi kryesor i të cilëve ishte zhdukja e trashëgimisë sonë orientale dhe identitetit islam.

Edhe pse Shqipëria është shtëpia e një prej popujve më të vjetër të Ballkanit dhe Europës, ne kemi vuajtur ndër shekuj duke humbur herë pas here identitetin tonë kulturor, i cili në ditët e sotme po zhduket edhe më shumë, duke i hapur rrugën një tranzicioni të plotë në një kulturë botërore të padallueshme.

Shqiptarët kanë vuajtur gjatë historisë, duke filluar nga barbarët grekë dhe sllavë që u përpoqën të shkatërronin kulturën dhe trashëgiminë tonë të prekshme. Por, kohët e fundit, në shekullin e kaluar (shek. 20), populli ynë ka vuajtur edhe nga pushtimi famëkeq komunist i Shqipërisë moderne (jo i trojeve të Shqipërisë etnike), ku regjimi komunist donte të tjetërsonte me forcë shqiptarët dhe kulturën e tyre duke krijuar "njeriun e ri", një individ që nuk do të ishte gjë tjetër veçse skllav i diktatorit, duke na lënë kështu pa asnjë identitet kulturor, kombëtar e fetar, të prekshëm apo të paprekshëm. Të njëjtën gjë po bëjnë tani edhe fëmijët e ish-komunistëve që sundojnë sot në Shqipëri, duke dashur të shkatërrojnë trashëgiminë dhe identitetin tonë në mënyrë "moderne dhe perëndimore".

Bazuar në ngjashmëritë kulturore dhe trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme që kemi të përbashkët me popullin uzbek, ne sigurisht dhe pa diskutim mund të jemi qendra rajonale për kulturën dhe trashëgiminë islame ku të dy popujt kemi trashëguar dhe duhet të ruajmë kulturat e ndryshme që paraardhësit tanë kanë zhvilluar. Ajo kulturë u përhap dhe u pranua nga pjesa më e madhe e shqiptarëve dhe uzbekëve dhe ka ndikuar në mënyrë të qëllimshme apo të paqëllimshme në kulturat tona vendase, si në aspektin gjuhësor, ashtu edhe në veshjet tradicionale, ushqimet dhe zakonet.

Shqipëria dhe Uzbekistani kanë nxjerrë gjithashtu shumë personalitete me famë botërore, të cilët janë bërë të famshëm ndër shekuj.

Disa nga figurat dhe personalitetet e njohur të Uzbekistanit përfshijnë Al-Fargani, Al-Khorazmi, Al-Biruni, Ismail El-Buhari, Hoxhë Behaaddin Nakshibendi, Et-Tirmidhi dhe Ibn

Sina (Avicena), ndërsa disa figura e personalitete të njohur shqiptarë përfshijnë arkitektin (Mimar) Sinani, arkitekt Kasem, Mehmed Aga, Muhamed Ali Pasha, Sami Frashëri, Shejh Nasrudin El-Albani, Abdul Kadr Arnauti, Hafiz Ali Korça, Vexhi Buharaja etj. Këta individë janë ndër njerëzit që kanë lënë një ndikim të rëndësishëm në kultivimin e kulturës sonë, të prekshme dhe të paprekshme, dhe janë të njohur në mbarë botën.

E veçanta e përmendjes së këtyre emrave në këtë artikull është se personalitete të tilla të njohura uzbekë dhe shqiptarë kanë dhënë kontribute në një periudhë të caktuar kohore, e cila ishte e njëjtë për të dy kombet tona. Kjo ishte koha e Epokës së Artë Islame, e cila për shqiptarët ishte gjatë periudhës osmane, duke bërë të mundur që trashëgimia jonë kulturore, e prekshme dhe e paprekshme, të lërë gjurmë në librat e historisë. Ndoshta figurat shqiptare që përmenda më lart nuk janë të njohura për shumicën e uzbekëve, studiuesve dhe historianëve, por figurat me origjinë uzbekë janë të njohura nga një numër i madh studiuesish, orientalistësh dhe kërkuesish shqiptarë.

Gjithashtu, qytete të njohur të Uzbekistanit me një kulturë dhe trashëgimi të madhe historike si Samarkand, Buhara, Tashkent, Andixhan, Khiva dhe Shahrisabz, si dhe qytete të njohura shqiptare me trashëgimi kulturore dhe historike si Berati, Gjirokastra, Shkodra, Elbasani, Korça, Ulqini, Gjakova, Kruja, Prizreni, Tetova dhe Shkupi, janë pjesë e trashëgimisë së pasur, të prekshme dhe të paprekshme, të të dy vendeve tona.

Këto trashëgimi, me mbështetjen e pakursyer të qeverive tona (nga Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës), si dhe me mbështetjen e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë (siç është UNESCO), duhet të ruhen dhe të prezantohen para gjithë botës si një pjesë thelbësore e trashëgimisë sonë kulturore dhe duhet të përfshihen në botime të ndryshme, duke mundësuar dhe nxjerrë studiues dhe turistë të ndryshëm që t'i vizitojnë ato.

Janë pikërisht këto veçori të dy popujve tanë, kultura dhe trashëgimia e prekshme dhe e paprekshme, që duhet të na bëjnë të ndihemi krenarë për atë që kemi trashëguar dhe për atë që jemi, e jo për atë që na kanë detyruar të huajt dhe armiqtë tanë që të jemi. Dhe kjo është pikërisht ajo që duhet t'i transmetohet fëmijëve tanë dhe brezave të rinj.

Ne duhet të punojmë më shumë për edukimin e brezave të rinj në shkollat tona për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore; kjo do të na bëjë neve të ndihemi më krenarë për historinë tonë dhe më të dukshëm për të gjithë botën.

Në këtë drejtim, Organizata e Trashëgimisë Kulturore të Uzbekistanit, në bashkëpunim me qeverinë e Uzbekistanit dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e trashëgimisë kulturore, mund të luajnë një rol të madh në promovimin e mëtejshëm të trashëgimisë kulturore të Uzbekistanit, të këtij vendi të bukur, historik dhe me trashëgimi të madhe, duke frymëzuar njerëz nga e gjithë bota që të vijnë e ta vizitojnë atë, dhe të bien në dashuri me të.

Zhvillimi njerëzor NË KUR'ANIN FAMËLARTË DHE HADITH

Dr. Albar është një mjek konsulent i Qendrës Kërkimore Mjekësore të Mbretit Fahd, Universiteti i Mbretit Abdul Aziz, në Xhidde të Arabisë Saudite. Në këtë studim të shkëlqyer, të shkruar në një gjuhë të thjeshtë me vetëm minimumin e fjalëve teknike, ai ka paraqitur një përmbledhje të njohurive aktuale rreth zhvillimit embrional të njeriut në dritën e Kur'anit dhe Hadithit.

Përshkrimet kuranore dhe ato të haditheve janë të shquara për saktësinë e tyre në lidhje me atë që është e njohur në kohët e sotme për temën në fjalë. Por, në ato kohë, çfarë dihej? Deri në vitin 1688, midis shkencëtarëve myslimanë dhe evropianë, mbizotëronte logjika aristoteliane dhe askush nuk guxonte ta vinte atë në pikëpyetje. Dy teoritë në kohën e Aristotelit ishin: E para, embrioni është i paraformuar si në miniaturë në spermën mashkullore ose në sekretimin femëror dhe pastaj rritet në mitër, dhe e dyta, embrioni në të vërtetë është formuar dhe krijuar nga gjaku i menstruacioneve. Aristoteli favorizonte pikëpamjen e dytë, duke shtuar se sperma mashkullore bën të mundur që gjaku menstrual të koagullohet, ashtu siç qumështi kthehet në djathë. Përshkrimi kuranor, në të kundërt, na tregon, se: E para, embrioni nuk është i paraformuar, por ai rritet në faza të njëpasnjëshme (71:13-14, 23:12-14, 22:5), dhe e dyta, ai është i formuar në mënyrë të barabartë nga lëngjet mashkullore dhe femërore (76:2). Hadithi përkatës rikonfirmon atë që është shpallur në Kur'an. Është interesant fakti se ekspertët e Kur'anit dhe Hadithit nuk kanë gabuar në interpretimin e tyre, por shumë shkencëtarë dhe mjekë myslimanë, nën idetë e Aristotelit, përsëritën pikëpamjen e tij të pasaktë. Kështu, rreth 700 vjet pas shpalljes së Kur'anit, Ibn Hajar al-Askalani komentoi: "Shumë anatomistë pohojnë se sperma e mashkullit nuk ka rol në krijimin e foshnjës. Roli i saj, pretendojnë ata, është i kufizuar në mpiksjen e gjakut menstrual... Thënia e Pejgamberit a.s. e mohon atë që thonë ata. Sperma e mashkullit në të vërtetë merr pjesë në mënyrë të barabartë me atë të femrës në formimin e embrionit".

Teoria e para-formimit të embrionit zgjati në Evropë deri në shekullin e 18-të, kur besohet se njeriu ekzistonte si i

plotë në miniaturë qoftë në vezën e femrës ose në spermën mashkullore, pastaj thjesht rritej në përmasa më të mëdha në mitër. Kjo teori u shkatërrua gradualisht dhe nuk mbeti më në asnjë formë pas vitit 1900. Von Baer (1829-37), i quajtur "babai i embrionologjisë", identifikoi dhe zbuloi vezën e njeriut te femrat. Ndarja e njëpasnjëshme e vezës, domethënë rritja e embrionit në faza të njëpasnjëshme, u demonstrua dhe u kuptua siç duhet në vitin 1839 nga Schwann dhe Schleiden. Ndërsa në vitin 1875, Hertwig përshkroi fekondimin e një veze nga një spermatozoid. Më pas në 1883, Von Benden tregoi se qelizat mashkullore dhe femërore kontribuojnë me të njëjtin numër të kromozomeve në formimin e embrionit.

Megjithatë, vetëm në shekullin e 20-të, një numër zbulimesh kanë përcaktuar se si dhe kur seksi i embrionit përcaktohet, si dhe kur zhvillohen eshtrat dhe muskulatura, organet e shikimit dhe të dëgjimit, sistemi nervor dhe kështu me radhë. Pra, është më se e çuditshme që në Kur'an dhe Hadith ne mund të gjejmë referenca të sakta dhe të detajuara për këto çështje të përmendura para 14 shekujsh.

Faza më e hershme e zhvillimit të embrionit është nutfeh, ku dallohen si nutfeh mashkullore dhe femërore (në terminologjinë moderne, gametet), të cilat duke u bashkuar të dyja formojnë nutfetin emshaxhin (zigota). Kur'ani e shpreh qartë dhe shprehimisht (75:3, 53:45-6, 59:8-9) se gjinia e embrionit bartet në lëngun e ejakuluar nga mashkulli (kromozomi X ose Y në spermën fertilizuese). Gjithashtu, në Kur'an theksohet se fekondimi kryhet nga një pikë lëngu e qartë, ku gjejmë një tregues të qartë për faktin se spermatozoidet përbëjnë vetëm 0.5% të lëngut të derdhur, në të cilën një sasi e vogël mbart mesatarisht 200 deri në 300 milionë spermatozoide individuale.

Nutfetin emshaxhin (zigota) më pas zhvillohet në alek (diçka që ngjitet), e cila i bashkëngjitet murit të mitrës. Saktësia mahnitëse e termit alek për detajet se si zigota i ngjitet, implantohet dhe ushqehet në murin e mitrës, është e habitshme në përshkrimin e Dr. Albar. (Për më shumë detaje, shih Sikander Hussain 'Al'Alaq: Misteri i eksploruar', Ark



Journal, London, 1986, f. 31-6.). Aleku transformohet më pas në mudgah, nga e cila diferencohen më pas eshtrat dhe muskujt. Faza e mudgah përfshin edhe harqet e faringut (nga të cilat formohen fytyra, veshët dhe qafa), karakteristikat e së cilës i japin embrionit pamjen e një 'mishi të përtypur'. Përshkrimi i Kur'anit (22:5) nga mukhal'leka dhe gajru mukhal'leka, formimi dhe zhvillimi i formuar i mudgah, kuptohet si periudha më kritike e organogenezës, kur embrioni është më i ndjeshëm ndaj faktorëve që mund të shkaktojnë keqformime kongjenitale. Kur'ani thotë (2:259): keje nenshuzu-ha thumme neksu-ha lehma, "si i ngremë ato (eshtrat), pastaj i fusim ato në mish". Nenshuzu-ha, këtu e përkthyer në mënyrë joadekuate "I ngremë ato" është aq informativ sa çdo përshkrim i librave të sotëm modern, sepse ka kuptimin "me kalimin e kohës formohen një numër strukturash si gjemba në formë rrezesh që shpërthejnë gradualisht nga qendrat kryesore të kockëzimit drejt periferisë".

Aspektet para-formuese të zhvillimit të embrionit tani janë të kuptueshme si karakteristika trashëgimore të kontribuara nga gjenet prindërore. Në Kur'an (81"17-19), nutfeh (gametet mashkull dhe femër) është thënë të kenë këto karakteristika të paracaktuara. Ka disa hadithe që e konfirmojnë këtë thënie. Një, në Sahihun e Muslimit, përmendet në mënyrë eksplicite që 40-42 ditë pas fekondimit, është momenti kur engjëlli hyn në barkun e nënës dhe "i jep nutfeh-s formën, krijon aparatin e të dëgjuarit dhe shikuarit, ndërton eshtrat, muskujt dhe formon lëkurën. Pastaj ai pyet Allahun xh.sh.: "O Zot, a do të jetë ai një djalë apo një vajzë, cila do të jetë mënyra e jetesës së tij dhe cila do të jetë jetëgjatësia e tij? Allahu i jep përgjigjen e Tij dhe engjëlli shkruan gjithçka që do të vijë më pas. Tekstet na tregojnë se "në javën e 6-të të zhvillimit, qelizat embrionale primordiale pushtojnë kreshtat gjenitale dhe nëse nuk arrin kreshtat, gonadet nuk zhvillohen. Vendi i formimit të gonadeve tregohet në Kur'an (86:5-9) si "midis shtyllës kurrizore dhe brinjëve". Kjo është saktësisht e drejtë. Sapo të formohen, gonadet dallohen në meshkujt dhe femrat dhe bëjnë progresin e tyre në trup në përputhje me kushtet

përkatëse. Furnizimi me gjak, inervimi dhe qarkullimi limfatik mbeten të lidhura, madje edhe tek të rriturit, në zonën "mes shtyllës kurrizore dhe brinjëve".

Në këtë shkrim të shkurtër janë përmendur vetëm disa prej përputhjeve të mëdha midis tekstit kuranor dhe haditheve, dhe njohurive aktuale rreth zhvillimit të embrionit njerëzor. Cila është rëndësia e vërejtjes së këtyre përputhjeve? Pothuajse të gjitha këto ajete kuranore kanë si kontekst të tyrin të përgjithshëm një kujtesë për ringjalljen. Rikrijimi i jetës dhe i njeriut pas vdekjes. Ne jemi të konfrontuar me faktin e jetës si një mrekulli mahnitëse e Mëshirës dhe Gjithëfuqishmërisë së Krijuesit. Njohja e fazave të njëpasnjëshme të rritjes nga një pikë e lëngjeve trupore deri në organizmin e përkryer njerëzor, nuk mund të mos krijojë ndjenjën e vetëdijes dhe përgjegjësinë që mbart për ne si njerëz me mendje, mrekullia e jetës. Atëherë, çfarë tjetër përveç perversitetit mund të na bëjë të dyshojmë se Krijuesi ynë nuk shqetësohet sesi e përdorim ne jetën tonë, ose dyshojmë se Ai mund dhe do të na sjellë përsëri në jetë, në mënyrë që ne të mund ta kuptojmë plotësisht vlerën e qëllimeve dhe veprimeve tona? Gjithashtu, këto ajete, duke nxitur një meditim më tepër mbi faktin e jetës sesa mbi faktin e vdekjes, edukojnë një temperament dhe qëndrim pozitiv. Përgjegjësia fetare mund të zgjidhet duke reflektuar mbi mrekullinë e lindjes, po aq sa duke reflektuar mbi misterin e vdekjes.

Asnjë libër mësimor rreth zhvillimit të embrionit njerëzor nuk mund të frymëzojë refleksime të këtij lloji. Natyrisht, është gjithashtu me rëndësi të madhe të dihet se informacioni në Kur'an, i dhënë me fjalë jashtëzakonisht të sakta, ende mbetet përgjithësisht i kuptueshëm pas 14 shekujsh të kaluar. Shumica e jomyslimanëve nuk besojnë se Kur'ani është Libri i Zotit fjalë për fjalë, siç besojnë mysliimanët. Duke u përpjekur për të kuptuar fenomenin, aq shumë të ilustruar nga Dr. Albar nga fusha e embrionologjisë njerëzore, se sa njohuri kaq të sakta ka në Kur'an, ato mund të nxiten për të vënë në dyshim sigurinë me të cilën qëndrojnë në mosbesim.

NJË VEPËR E VOGËL QË SHPËTOI NJË JETË

Çdo të premte pas namazit, imami dhe djali i tij 11-vjeçar dëlnin nëpër lagjet e qytetit duke shpërndarë broshura me titull "Rruga për në Parajsë". Ishte bërë zakon për ta - një mision i vogël, por i rëndësishëm.

Një të premte, moti ishte shumë i keq. Shi i dendur dhe erë e ftohtë. Imami, duke parë nga dritarja, tha me zë të butë:

"Bir, sot është shumë ftohtë. Nuk kemi pse të dalim."

Djali, i veshur trashë dhe me zemër të vendosur, e pa babain i habitur:

"Babi, edhe nëse bie shi... njerëzit ende kanë nevojë për Zotin, apo jo?"

Imami heshti për një çast. Djali vazhdoi:

Atëherë... a mund të shkoj unë vetë?"

Pas pak hezitimi, babai i dha broshurat dhe i tha:

"Mirë, bir. Shko me kujdes. Zoti të udhëzoftë."

Djali doli në shi dhe shpërndau broshura derë më derë. I mbeti vetëm një broshurë. Edhe pse ishte i lodhur e i lagur, vendosi të trokasë në një derë të fundit. Nuk mori përgjigje; trokiti sërish... asgjë. Ishte gati të largohej, por diçka e shtyu të trokasë edhe një herë, më fort.

Dera u hap ngadalë. Para tij u shfaq një grua e moshuar, me fytyrë të lodhur dhe sy të mbushur me trishtim.

Ajo pyeti me zë të vogël:

- "Po ti, bir... çfarë kërkon në një ditë kaq të ftohtë?"

Djali buzëqeshi, i lumtur që më në fund dikush u përgjigj:

- "Zonjë, më falni që ju shqetësova... por unë thjesht dua t'ju them se Allahu ju do dhe kujdeset për ju."

Gruaja e pa e habitur. Djali vazhdoi, duke ia zgjatur broshurën:

- "Kjo është broshura ime e fundit... dhe doja t'ia jepja dikujt që ka vërtet nevojë. Shpresoj t'ju sjellë pak dritë."

Gruaja mori broshurën me duar që i dridheshin:

- "Faleminderit, bir... Zoti të bekoftë."

Djali u largua duke vrapuar nëpër shi, i lumtur që e kishte përfunduar detyrën e tij.

Të nesërmen, në xhami, imami pyeti xhematin nëse dikush kishte diçka për të ndarë. Një grua e moshuar u ngrit ngadalë. Ishte po ajo grua. Me zë të dridhur, ajo tregoi se kishte jetuar e vetmuar që nga vdekja e bashkëshortit të saj dhe atë ditë, përpara se djali të trokiste, ajo kishte humbur çdo shpresë.

Ajo tha:

- "Në çastin kur ai trokiti, unë isha gati t'i jepja fund jetës sime. Por zëri i tij... buzëqeshja e tij... fjalët që Allahu më do... më shpëtuan. Broshura e tij më riktheu dritën."

Xhemati u prek thellë. Imami, me lot në sy, e ngriti djalin e tij në krahë dhe e përqafoi fort. Askush nuk foli - vetëm lot dhe falënderime ndaj Zotit për mrekullinë që kishte ndodhur përmes një fëmije.

Asnjë vepër e mirë, sado e vogël të duket, nuk është e parëndësishme.

Ndonjëherë një fjalë e butë, një buzëqeshje, ose një trokitje e thjeshtë mund të ndryshojë, madje të shpëtojë një jetë.

FJALËT E NJË KALORËSI



Para se të largohem nga bota, po t'i jap fjalët dhe lotët
"Mos u zemëro!" - tha tri herë radhazi, ai që erdhi mëshirë për botët
"Në botë jam si kalorësi që pushon nën hijen e një druri pak,
pastaj e braktis atë dhe ikën shpejt me vrap"
Shumë perëndime të diellit në jetë të vetmuar do të të gjejnë
Mos u pikëllo kur njerëzit të mirat me të keq do t'i kthejnë
Në botë jetojnë shpirta që kuptojnë por nuk ndjejnë
Ata që të duan të vogël, kur je i madh të urrejnë.

Vetmia do zbresë në zemrën tënde, errësira do zbresë në sytë e tu
Do jesh i braktisur nga njerëzit edhe pse njerëzit do jenë këtu
Dikush do ta falë zemrën e vet por zemrën tënde ka për ta vrarë
Nga ndarjet e kësaj bote s'ka mbetur shpirt pa qarë
Edhe ti do të qash si fëmija që me vaj dëshiron t'i përmbush dëshirat
Deri sa të kuptosh se bota s'është Zot që mund të t'i japë gjithë të mirat.

Mos u dëshpëro nëse njerëzit të bëjnë të ndjehesh vetëm në këtë jetë
Mos harro se barku njerëzor bluan e tret gjëra më të forta se sa vetë
por kur mbetet fare bosh, veten nuk e bluan as s'e tret!
Do të të plagosin mu në zemër ata që zemrën ua ke falë
Por ti do forcohesh se s'ka dhimbje që rrugën tek Pafundësia ta ndal
Nëse ata që ua tregove emrin, në emër të thërrasin
Edhe ata që ua tregove plagën, në plagë do të të godasin
Çdo plagë do të dëshmojë forcën tënde me të cilën ti do ngrihesh
Jeto si thesar që edhe kur zbulohesh, çmohesh njësoj, si kur fshihesh!

Nëse te uji të çon etja e te ushqimi uria
Mos harro se te vuajtjet të çojnë dëshira dhe dashuria
Por ti do të durosh se vuajtjet s'jetojnë për jetë të jetëve
Ata që duan mjaltin, durojnë pickimin e bletëve.
Atje ku të paditurit janë të lumtur, mençuria jote nuk do të vlejë
Pasuria e një shpirti njerëzor matet me atë se sa mund të ndjejë
Nëse mendja s'e arrin lartësinë e ndjenjave
Kot do flasësh, kot do thërrasësh në drejtim të zemrave.

Para se të largohem nga bota, po t'i jap fjalët që i mësova në botë
Që fjalët të mos harrohen, po t'i perziej me lotë
Në shkretëtirat e jetës ku nuk del ujë, kurrë mos gërmo
Kur të përbuzin dhe dëbojnë, fal por kurrë mos harro
Përgjigja jote ndaj të pamendëve le të jetë veç heshtja
I mençuri në mesin e të pamendëve është i bukur dhe i trishtë si vjeshta
Nga ngjyrat e mëshirës hyjnore në fytyrë do të të pikturohet buzëqeshja
Do të dish të jetosh nëse mëson si të vdesësh
Të gjitha janë brenda teje, nga jashtë s'ke çfarë të presësh.
Tani më duhet të ik, mund të më përshëndesësh!



**2000
lekë**

Revista "Drita Islame" ka nisur abonimet për vitin 2026

- ✓ Abonimet fillojnë që nga ky muaj
- ✓ Vlera e abonimit vjetor 2000 lekë

Për ta bërë tuajën këtë revistë:

- ✓ Kontaktoni në numrin 068 87 71 655
- ✓ Drejtohuni pranë myftinive përkatëse
- ✓ Vizitoni Komunitetin Mysliman të Shqipërisë